



**PUBLIKU I GJERË**

**Studimi i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave mbi ndryshimet klimatike dhe mjedisin**

**unicef**   
for every child

 **Sweden**  
**Sverige**

# Studimi i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave mbi ndryshimet klimatike dhe mjedisin

Publiku i gjerë

**2021**

Hulumtimi është realizuar nga agjencia Rating nga Shkupi, në kuadër të projektit “Fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve për të qenë shtytës të ndryshimit në zvogëlimin e cenueshmërisë së komunitetit ndaj ndryshimeve klimatike” i zbatuar nga UNICEF-i me mbështetjen financiare të Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet zyrtare të UNICEF-it dhe pikëpamjet e Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, andaj ato nuk janë përgjegjëse për çdo përdorim të mundshëm të të dhënave që i përmban hulumtimi.

## Tabela

Hyrje .....	Error! Bookmark not defined.
1. Çfarë e ka formuar opinionin publik mbi ndryshimet klimatike në Maqedoninë e Veriut? .....	1
2. Problemet më të mëdha, me të cilat përballen qytetarët e Maqedonisë së Veriut ...	3
3. Njohuritë mbi ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre ndaj mjedisit/shoqërisë/njerëzve .....	6
4. Pikëpamjet dhe stereotipet për ndryshimin e klimës.....	17
4.1. Pikëpamjet dhe stereotipat për ndryshimin e klimës .....	18
4.2. Pikëpamjet mbi zgjidhjet e mundshme për t'i zvogëluar ndryshimet klimatike ..	21
4.3. Qëndrimet që e përcaktojnë veprimin shoqëror .....	22
5. Perceptimi i përgjegjësisë dhe veprimi institucional.....	0
6. Perceptimi i përgjegjësisë dhe veprimi institucional.....	1
7. Mediat dhe burimet e informimit.....	1
8. Metodologjia e hulumtimit.....	0
9. Demografia .....	0
10. Shtojca – Pyetësi për publikun e gjerë.....	3

## Hyrje

Dy vitet e fundit kanë vënë theks të veçantë në problemet, me të cilat përballlet bota, liderët botërorë dhe entitetet mbi kombëtare në nivel global. Megjithatë, ajo që u shënua më thellë në këtë periudhë të historisë së re është fakti se problemet globale janë shndërruar në vendore – të dukshme për qytetarin e thjeshtë, ndërsa përballja me to është bërë detyrim dhe domosdoshmëri e çdo vendi pa përjashtim. Për shembull, sot asnjë vend nuk është i kursyer nga pandemia Covid-19, dhe si rrjedhojë e kësaj as edhe nga krizat ekonomike, arsimore, të sigurisë dhe krizat e tjera të mëvonshme. Në këtë drejtim mbretëron vetëdija se asnjë vend nuk mund t'i zgjidhë vetë këto kriza, gjë që kontribuoi në nxiten e bashkëpunimit midis vendeve si një faktor parësor për vënien nën kontroll të pandemisë. Një nga ndryshimet më domethënëse që po ndodh në shekullin e 21-të është sigurisht ndërgjegjësimi në rritje për ndërvarësinë e njerëzimit. Njerëzimi po ndërgjegjësohet se ka probleme që asnjë individ apo shtet nuk mund t'i zgjidhë në mënyrë të pavarur dhe pa bashkëpunimin e të tjerëve. Këtu përfshihen çështjet e: ndotjes së tokës, trajtimit të ndryshimeve klimatike, terrorizmit global, pandemive globale, migrimit masiv dhe shumë fenomeneve tjera para të cilave individët dhe shtetet qëndrojnë të pafuqishëm, nëse nuk ka veprim të përbashkët dhe të sinkronizuar. Në këtë drejtim, sfidat e ndryshimeve klimatike po bëhen gjithnjë e më serioze, aktuale dhe akute me një numër rekord të fatkeqësive natyrore. NASA e renditi vitin 2020 si një nga vitet më të nxehta dhe 7 vitet e fundit si vitet më të ngrohta në historinë njerëzore<sup>1</sup>. Ngjarjet ekstreme të motit si zjarret, përmbytjet, uraganet dhe valët e të nxehtit janë shumë më të shpeshta dhe më intensive, duke vënë kështu “agjendën e gjelbër” në tryezën e shumë qeverive, që deri vonë nuk mendonin për ndryshimet klimatike me kujdesin e duhur ose qëndronin indiferente ndaj këtyre çështjet.

Për sa iu përket ndryshimeve klimatike, njerëzimi është në garë mes dy pika qenësore. E para ka të bëjë me ekosistemet e Tokës dhe jetën brenda, një pikë që shpie në një kolaps të pakthyeshem për shkak të ndryshimeve klimatike. Pika e dytë qenësore ka të bëjë me veprimin klimatik dhe momentin kur kjo luftë do të pushojë së qeni vetëm një nga shqetësimet e shumta politike, duke u shndërruar në një lëvizje sociale masive. Natyrisht pyetja më e rëndësishme është – cilin moment historik do të arrijmë së pari?

Studimi në fjalë i mat njohuritë e përgjithshme të qytetarëve të Maqedonisë së Veriut në lidhje me ndryshimet klimatike, duke përfshirë kuptimin dhe asociacionet e vetë nocionit, por edhe efektin që kanë ndryshimet klimatike në shoqëri. Ai mat gjithashtu qëndrimet ndaj ndryshimeve klimatike, veçanërisht nivelin e shqetësimit për problemin, perceptimin e të anketuarve për rëndësinë e aktiviteteve të caktuara që mund të jenë vendimtare në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe gatishmërinë e të anketuarve për të ndërmarrë veprime dhe për të qenë pjesë e zgjidhjes për këtë problem. Ky hulumtim do të përpiqet të zbulojë se cilat praktika dhe aktivitete janë më të zakonshme në mesin e qytetarëve, si dhe do të synojë t'i përcaktojë barrierat e mundshme që i pengojnë ose dekurajojnë njerëzit të bëhen qytetarë aktivë.

---

<sup>1</sup> Viti 2020 i regjistruar si vitin më i ngrohtë, Shfaqja e Analizës së NASA-s (qasur për herë të fundit më 18 gusht 2021)

<https://www.giss.nasa.gov/research/news/20210114/>



Për në fund, ky studim i mat zakonet dhe mjetet e informimit të qytetarëve si një nga faktorët kyç në formësimin dhe krijimin e opinionit publik.

## 1. Çfarë e ka formuar opinionin publik mbi ndryshimet klimatike në Maqedoninë e Veriut?

Përsëri këtë vit Maqedonia e Veriut është përballë me shumë përmbajtje dhe zjarre, temperatura të larta gjatë verës dhe valë të nxehtit, që do të thotë se opinionin publik është krijuar në një nga mënyrat më të dhimbshme – përmes dëshmimeve personale dhe të drejtpërdrejta, me çka qytetarët janë ndërgjegjësuar për kërcënimin real, me të cilin përballen. Kjo nënkupton që është e rëndësishme të vendoset menaxhimi i ndryshimeve klimatike në qendër të vëmendjes – jo vetëm të publikut por edhe të të gjitha institucioneve përkatëse vendimmarrëse – veç kësaj duhet të potencohet edhe kostoja e injorimit të këtij rreziku të madh, që e kërcënon të ardhmen e njerëzimit.

Ndër vite në media kanë qenë të pranishme edhe temat, që e kanë formuar dhe formësuar vazhdimisht opinionin publik: ndotja e madhe e ajrit, veçanërisht në periudhën e dimrit, hapja e minierave në disa rajone të vendit, hapja e hidrocentraleve të vegjël dhe shfrytëzimi i burimeve ujore, hapja e impianteve të përpunimit të mbetjeve, gazifikimi i amvisërive dhe tema tjera.

Edhe pse grumbullimi i të dhënave për Studimin e Ndryshimeve Klimatike dhe Mjedisit u realizua përpara zjarreve të mëdha, për shuarjen e të cilëve nevojitej ndihmë e huaj, megjithatë periudha e mbledhjes së të dhënave u karakterizua edhe më tej nga temperatura mbi mesataren, thatësira ekstreme dhe moti i thatë pa shi. Gjatë kryerjes së punëve në terren rreth studimit, vendi ishte në fazën portokalli, ndërsa autoritetet kishin dhënë veç më rekomandime për mbrojtje dhe masa paraprake për qytetarët për shkak të temperaturave të larta. Ndryshimet e pafavorshme klimatike kanë gjithashtu një ndikim të rëndësishëm në bujqësinë e vendit. Gjithashtu, si rezultat i thatësirave në rritje e sipër në vitin 2021, fermerët përballen edhe me uljen e prodhimit për rreth 30 për qind, duke përfshirë edhe vështirësitë në mbrojtjen e të korrave, ndërkohë që blegtorët përballen me ulje të prodhimit të qumështit dhe produkteve të tjera blegtorale.

Këtë vit mediat kanë raportuar për zjarre të mëdha në mbarë botën, nga Shtetet e Bashkuara në Rusi, nga Kanadaja deri në Australi, dhe nga Rumania dhe Turqia në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe kanë raportuar për betejat e zhvilluara me përpjekjet mbinjerëzore për t'i shpëtuar pyjet, kafshët e egra, jetët dhe pronat e njerëzve. Mediat maqedonase, të cilat në mënyrë sistematike kanë raportuar për zjarret në vendin tonë dhe në mbarë botën, kanë thënë se sipas shkencëtarëve, **botë ka shënuar numrin më të madh të zjarreve në korrik të këtij viti, pasi ky fenomen ka filluar të monitorohet përmes satelitit në vitin 2003**<sup>2</sup>. Për më tepër, për shkak të

---

<sup>2</sup> Korriku e regjtroi numrin më të madh të zjarreve në botë, që nga fillimi i gjurmimit satelitor në vitin 2003 <https://www.radiomof.mk/vo-juli-registrirani-najmnogu-pozhari-vo-svetot-otkako-satelitski-se-sledi-od-2003-godina/> (qasur për here të fundit më 23/08/2021)

temperaturave ekstreme, thatësirës së zgjatur dhe zjarreve në pyje, **343 megaton dyoksid karboni është lëshuar në atmosferë, pra afërsisht një e pesta e nivelit më të lartë të mëparshëm të zjarreve dhe valëve të të nxehtit për muajin korrik, të monitoruar nga viti 2014.** Shkencëtarët theksojnë se zjarret e regjistruara në vitin 2021 deri në këtë pikë janë vetëm të fundit në një sërë fenomenesh të padëshiruara në kohët e fundit që **“janë rezultat i efekteve katastrofike të ngrohjes globale të shkaktuar nga njeriu”**. Më shumë se gjysma e dyoksidit të karbonit vjen nga dy rajone me mot jashtëzakonisht të nxehtë dhe të thatë - Amerika e Veriut dhe Siberia. Në Kanadanë perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara, zjarret u shoqëruan me nxehtësi të zgjatur dhe intensive, dhe në Siberi, pjesa më e madhe e Taigës<sup>3</sup> u përfshi nga flakët dhe retë e tymit helmues që u përhapën në Polin e Veriut. Këto dukuri po përhapen në Mesdheun lindor dhe qendror, ku shumë vende po përjetojnë një fillim jashtëzakonisht të ashpër të sezonit të zjarreve.

Media gjithashtu e kanë raportuar lajmin qendror se sipas Administratës Kombëtare Oqeanike dhe Atmosferike të SHBA-së (NOAA), **temperatura mesatare e sipërfaqes së tokës dhe oqeanit në botë ishte 0,01 gradë Celsius më e lartë në korrik të vitit 2021 sesa në korrikun e mëparshëm më të nxehtë të vitit 2016, me çka u bë muaji më i nxehtë në 147 vitet e fundit**, që kur nisën të regjistroheshin statistikat.

Në kohën e zjarreve, pjesa më e madhe e Evropës ishte gjithashtu e mbuluar nga **përmbytjet** shkatërruese. Mediat raportuan për përmbytje katastrofike në Gjermani, të cilat vranë më shumë se 150 njerëz, në Austri, Belgjikë, Holandë, Turqi, Londër, Indi dhe shumë vende të tjera të botës. Përmbytjet në Gjermani i tronditën shkencëtarët e klimës. Pavarësisht njohurive të tyre për të këqijat e ndryshimeve klimatike, ata u befasuan nga intensiteti dhe shkalla e fatkeqësive natyrore, që e goditën planetin tonë. Agjencia Amerikane e Hapësirës tha se përmbytjet mund të rriten deri në vitin 2030 si rezultat i ndryshimeve klimatike.

Pas ndërrimit të qeverisë në shkurt të vitit 2021 Shtetet e Bashkuara, vetëm 107 ditë pas largimit e nënshkruan rikthimin në Marrëveshjen e Parisit. Ekspertët amerikanë presin që objektivi për t'i reduktuar emetimet e karbonit deri në vitin 2030 të jetë ndërmjet 40 për qind dhe 50 për qind të niveleve bazë të vitit 2005. Në korrik të vitit 2021, Komisioni Evropian e shpalli programin e tij “Fit for55” (i gatshëm për 55). Ky program përmban 12 propozime për ndryshime të reja legjislative përmes të cilave do të zbatohet Marrëveshja e Gjelbër Evropiane dhe zbatimi i të cilave pritet t'i reduktojë emetimet e gazeve serrë për 55 për qind deri në vitin 2030.

Zyra e OKB-së për Maqedoninë e Veriut, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e miratuan programin e titulluar “Synimet për objektivin 13” në kuadër të Veprimit për Klimën. Ministria i zbaton politika për mbrojtjen e mjedisit, inspektoratet e saj po i monitorojnë emetimet dhe ndotjen e gazrave serrë (GS), ndërsa vendi po përgatitet ta zëvendësojë qymyrin me gazifikimin, si dhe energjinë e erës dhe atë solare. Plani i Katërt Nacional i Ndryshimeve Klimatike (PN i 4-të) aktualisht është duke u përgatitur dhe pritet të përfundojë dhe miratohet nga Qeveria në vitin 2022.

---

<sup>3</sup> Emri për pyjet e mëdha me gjelbërim të përhershëm të Evropës Veriore dhe Azisë Veriore

Dy parti politike në Maqedoninë e Veriut u deklaruan qartë si parti të gjelbra. Njëra prej tyre është partia DOM, e cila është anëtare e Aleancës së Partisë së Gjelbër Evropiane, dhe partia BDI, e cila së fundmi njoftoi transformimin e saj në një parti të gjelbër me agjendën e saj të gjelbër.

Sigurisht që opinioni publik për ndryshimet klimatike në Maqedoninë e Veriut është i ndikuar nga organizata të shumta joqeveritare, që përmes aktiviteteve dhe faqeve të tyre të internetit, ndikojnë në ngritjen e ndërgjegjësimit për nevojën e ndërmarrjes së masave kundër ndryshimeve klimatike, dhe të cilat përmes publikut, madje edhe përmes protestave, veprojnë si kontrollues të ndotësve dhe moszbatues të politikave të akorduara. Ato përfshijnë: Shoqërinë Ekologjike Maqedonase, Eko Ndërgjegjen, Eko Guerilla, Qendrën për Ndryshime Klimatike, Koalicionin O2, Lëvizjen Ballkanike për Përmirësimin e Standardeve të Jetesës duke përmirësuar Mjedisin dhe organizatat tjera, që veprojnë në nivel nacional dhe lokal. Në vend ekziston edhe një portal i specializuar për adresimin e çështjeve, që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike – [www.klimatskipromeni.mk](http://www.klimatskipromeni.mk).

UNICEF-i në Maqedoninë e Veriut e ka njohur urgjencën e problemit dhe nevojën për ta analizuar gjendjen e opinionit publik, duke kryer një anketë sasiore të qëndrimeve dhe besimeve shoqërore, që ndërlidhen me ndryshimet klimatike dhe mjedisin. Anketa është realizuar me 1200 të anketuar, një mostër reprezentative e të gjithë vendit, duke përfshirë popullsinë mbi 5 vjeç e më të vjetër.

Qëllimi kryesor i këtij sondazhi, që synon publikun e gjerë, është të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të njohurive, qëndrimeve dhe praktikave aktuale në lidhje me ndryshimet klimatike dhe mjedisin (Studimi i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave - KAP). Qëllimi i hulumtimit është t'i identifikojë perceptimet, qëndrimet dhe praktikat e qytetarëve në lidhje me ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit dhe të japë një vlerësim të përgjithshëm të asaj që mund të jetë pengesë, boshllëk ose anomali në zbatimin e edukimit mjedisor dhe pranimin të mënyrës së jetesës eko-neutrale dhe zakoneve (praktikave) të sjelljes. Të dhënat e gjeneruara nga ky hulumtim do të shërbejnë gjithashtu për të krijuar aktivitete dhe iniciativa komunikimi për publikun e gjerë, duke krijuar fushata për ta rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm mbi këto tema.

Për qëllimet e studimit u zhvillua një pyetësor strukturor, i cili fokusohet në mënyrë specifike në fushat e mëposhtme:

1. Njohuritë për ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tyre ndaj mjedisit
2. Qëndrimet ndaj ndryshimeve klimatike dhe ndikimi i tyre në mjedis
3. Perceptimi i përgjegjësisë dhe veprimi institucional
4. Praktikrat më të zakonshme të qytetarëve
5. Mediat dhe mënyrat e të qenit të informuar

## **2. Problemet më të mëdha, me të cilat përballen qytetarët e Maqedonisë së Veriut**

Përpara se të analizohen çështjet thelbësore, të cilat janë në qendër të këtij studimi, është e nevojshme të rishikohen përgjigjet e të anketuarve, duke i evidentuar kështu problemet parësore me të cilat përballen qytetarët në vend. Kjo analizë, së bashku me kontekstin në të cilin është formuar opinioni publik, është veçanërisht e rëndësishme për të paktën dy arsye. Së pari, ky grup pyetjesh (përfshirë të dhënat demografike) ofron një përmbledhje të një sërë indikatorësh socio-ekonomikë, që ndërlidhen me mirëqenien e qytetarëve dhe së dyti, duke i lokalizuar problemet kryesore –rrjedhimisht prioritetet e qytetarëve – ne mund t'i nxjerrim konkluzionet e duhura nga gjetjet kryesore të studimit.

Analiza tregon se qytetarët janë më të shqetësuar për standardin e dobët të jetesës dhe varfërinë që mbizotëron në vend, ku gati se çdo katër nga dhjetë qytetarë janë të shqetësuar për këtë problem. Fakti që kjo çështje është evidentuar si parësore, tregojnë edhe disa studime socio-ekonomike të kryera që nga fillimi i vitit 2021 e deri më tani. Prandaj, kjo çështje radhitet si e e para, pasuar nga papunësia (34.8 për qind) e cila shfaqet si çështja e dytë më e rëndësishme. Kostot e larta të jetesës (29,6 përqind) dhe pagat e ulëta (29 për qind) janë problemi i tretë i renditjes, me të cilin përballen qytetarët e Maqedonisë. **Problemet kryesore janë padyshim të ndërlidhura dhe janë kryesisht ekonomike/financiare.**


Çështjet që vijojnë më pas sipas intensitetit përfshijnë: emigracionin e të rinjve për shkak të kushteve të këqija të jetesës (26.5 për qind) dhe mungesën e perspektivës dhe mundësive për të rinjtë (18.1 për qind), probleme të theksuara veçanërisht nga popullsia më e re e moshës 15 deri në 29 vjeç, gjë që është e pritshme pasi ata janë më të prekura nga këto sfida. Për të rinjtë, papunësia mbetet problemi më i madh.

Korrupsioni është problem për rreth një të katërtën e të anketuarve.

Qytetarët nuk shprehin shqetësime të veçanta për ndotjen e ajrit dhe mjedisit, pasi vetëm 8.4 për qind e të anketuarve kanë shprehur shqetësime për këtë problem dhe pak më pak se kaq, vetëm 4.5 për qind kanë shprehur shqetësime për ndryshimet klimatike/ngrohjen globale. Gjetjet e tilla nuk janë befasuese nëse merren parasysh problemet kryesore, që i theksuam më herët, si dhe çështjet e standardit të jetesës dhe fuqisë blerëse të qytetarëve të analizuarra më poshtë.




P1. Cilat janë tre shqetësimet/problemet kryesore me të cilat përballeni aktualisht?  
(Mund të zgjedhni më shumë përgjigje) N=1200




Perceptimi i qytetarëve është se standardi i jetesës në vend është në nivele të palakmueshme. Për dy në dhjetë qytetarë standardi i jetesës është i padurueshëm, ndërsa katër në dhjetë qytetarë janë përgjigjur se është e vështirë të jetosh në vend, por megjithatë është e përballueshme. Standardi i jetesës është i shkëlqyer vetëm për 1.5 për qind të qytetarëve dhe rreth 12 për qind e tyre shprejnë se mund të përmirësohet standardi i jetesës në vend.

P28. Sipas mendimit tuaj, cila nga pohimet e mëposhtme e përshkruan më mirë standardin aktual të jetesës në vendin tuaj? N=1200



Për sa i përket fuqisë blerëse, grafiku i mëposhtëm tregon se shumica e qytetarëve të Maqedonisë jetojnë “nga dita në ditë”. Pothuajse gjysma e të anketuarve deklaruan se mund ta blinin vetëm atë që ishte e nevojshme (47.9 për qind), ndërsa 41.9 për qind thanë se mund të blinin pak më shumë se sa më nevojitet. Rreth 7 për qind e të anketuarve jetojnë në varfëri.

P29. Cila nga pohimet e mëposhtme vlen për ju? N=1200



Sa i përket pyetjes “A prisni që vitin e ardhshëm standardi juaj i jetesës të përmirësohet, përkeqësohet apo të mbetet i njëjtë?”, shumica e të anketuarve nuk presin ndonjë ndryshim, d.m.th., ata janë përgjigjur se standardi i tyre i jetesës nuk do të ndryshojë ndjeshëm (48.5 për qind). Vetëm 16.9 për qind e tyre mendojnë se standardi i tyre i jetesës do të përmirësohet, për dallim nga të anketuarit, që mendojnë se do të përkeqësohet (24.3 për qind).

Të dhënat krahasuese nga analiza tregojnë se burrat ishin më pesimistë se gratë, të anketuarit më të vjetër mbi 50 vjeç ishin më pesimistë se grupmoshat më të reja dhe maqedonasit etnikë ishin më pesimistë se shqiptarët etnikë, të cilët presin një përmirësim në standardet e tyre të jetesës.


### 3. Njohuritë mbi ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre ndaj mjedisit/shoqërisë/njerëzve

Njohuria është përgjithësisht një parakusht bazë, që njerëzit të jenë në gjendje të kuptojnë një çështje të caktuar dhe implikimet e saj. Çdo mungesë njohurie lidhet me indiferencën dhe paaftësinë për ta njohur nevojën për të vepruar qoftë individualisht ashtu edhe kolektivisht. Ky grup pyetjesh i mat njohuritë dhe/ose ndërgjegjësimin e qytetarëve për ndryshimet klimatike dhe mjedisin. Në fakt është indikator i parë, që na ndihmon të kuptojmë opinionin publik.

Një pjesë e madhe e qytetarëve (15 për qind) nuk kanë përgjigje në pyetjen “Cili është mendimi juaj i parë kur e dëgjoni nocionin ndryshimi i klimës?”. Kjo përqindje është dukshëm e lartë dhe mund të jetë për shkak të mungesës së interesit të të anketuarve për t’u përgjigjur në pyetjen të llojit të hapur me fjalët e tyre dhe/ose njohurive të tyre të pamjaftueshme ose mungesës së tyre në lidhje me konceptin e ndryshimit klimatik, duke rezultuar në hezitimi për t’u përgjigjur pyetjes. Të dhënat e kryqëzuara tregojnë gjithashtu se të anketuarit me të hyra mujore deri në 10.000 denarë, të anketuarit me arsim fillor të përfunduar ose pa arsim dhe të moshuarit kanë shprehur dukshëm më pak asociacione në krahasim me kategoritë e tjera të të anketuarve.

Sa i përket të anketuarve që iu përgjigjën pyetjes, dy shoqatat e para kur e dëgjojnë nocionin “ndryshimi i klimës” përfshijnë ngrohjen globale (9.3 për qind) dhe ndryshimin e shpeshtë të stinëve (9.1 për qind). Ngrohja globale<sup>4</sup> është një lidhje më e fortë për burrat, të anketuarit që jetojnë në zonat urbane dhe ata me arsim sipëror në krahasim me kategoritë e tjera të të anketuarve. Nociione tjera të përsëritura në asocimet e dhëna nga qytetarët përfshijnë: përmbytjet e shpeshta (6,5 për qind), thatësitat dhe përmbytjet (5,9 për qind), ndotjen e ajrit (5,2 për qind), zhvendosjen e stinëve (4,9 për qind), fatkeqësitë natyrore (4,4 për qind) dhe ndryshimet e shpeshtë të temperaturës, (4.3 për qind). Për vëzhgim më të lehtë përgjigjet e të anketuarve janë grupuar sipas kategorive në grafikun e mëposhtëm.

P2. Cili është mendimi juaj i parë kur e dëgjoni nocionin “ndryshimi i klimës”? (pyetje e llojit të hapur) N=1200



Sfida kryesore gjatë hulumtimit të njohurive, qëndrimeve dhe praktikave është të dallohet kur të anketuarit japin përgjigje të dëshirueshme shoqërore, edhe kur ata nuk pajtohen vërtet ose nuk kanë një mendim specifik për një temë të caktuar. Për


<sup>4</sup> Megjithëse njerëzit priren t'i përdorin këto terma në mënyrë të ndërsjellë, ngrohja globale është vetëm një aspekt i ndryshimit të klimës; Cili është dalimi midis ndryshimit të klimës dhe ngrohjes globale? <https://climate.nasa.gov/fag/12/whats-the-difference-between-climate-change-and-global-warming/> (qasja e fundit më 18 gusht 2021)

shembull, megjithëse të anketuarit i renditin ndryshimet klimatike në një nivel shumë të ulët në spektrin e shqetësimeve dhe problemeve të përditshme (problem për rreth 5 për qind të të anketuarve), kur u pyetën drejtpërdrejt për këto çështje, shumica e qytetarëve shprehën shqetësimin e tyre për ndryshimin e klimës (43.5 për qind ishin shumë të shqetësuar dhe 29.6 për qind kryesisht të shqetësuar). Rreth 10 për qind nuk shqetësohen fare me ndryshimet klimatike, ndërsa rreth 17 për qind e numrit të përgjithshëm të të anketuarve janë kryesisht të pashqetësuar. Rezultatet e kryqëzuara tregojnë se të anketuarit që kanë ndërmarrë personalisht veprime specifike për ta mbrojtur mjedisin e shprehin shqetësimin më të madh në krahasim me të anketuarit, që nuk janë palë aktive të interesit. Gjithashtu, të anketuarit që janë më të motivuar (plotësisht ose disi të motivuar) për t'u përfshirë në aktivitete që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit shprehën shqetësim shumë më të madh për ndryshimet klimatike sesa kategoritë e tjera të të anketuarve. Për më tepër, shqetësim më i madh për ndryshimet klimatike u shpreh nga të anketuarit e vendbanimeve urbane në krahasim me ata të mjediseve rurale, gjegjësisht të anketuarit me arsim sipëror në krahasim me të anketuarit pa arsimim ose me arsim fillor dhe grupet më të vjetra të qytetarëve në krahasim me qytetarët më të rinj (mosha 15-29). Të anketuarit më të rinj janë mesatarisht të shqetësuar për ndryshimet klimatike.

Të anketuarit me të ardhura mujore deri në 18.000 denarë kanë shprehur shqetësim shumë më të madh për mjedisin se sa të anketuarit e tjerë me të ardhura më të larta. Ky është një fakt veçanërisht i rëndësishëm, sepse varfëria dhe ndryshimi i klimës janë të ndërlidhura aq thellë sa luftimi i njërit prej këtyre problemeve mund të ndihmojë në trajtimin/zbutjen e tjetrit. Konstatimi se qytetarët me të ardhura mujore nën mesataren janë shumë më të shqetësuar për problemin e ndryshimeve klimatike mund të drejtohet drejt zhvillimit të koncepteve dhe strategjive të komunikimit me këtë grup qytetarësh. Gjithashtu, theksojmë faktin se vetëm 16,3 për qind e të anketuarve me të ardhura mujore deri në 18.000 denarë, të cilët e kanë shprehur shqetësimin për ndryshimet klimatike, nuk kanë shprehur ndonjë asociacion lidhur me këtë koncept. Për të anketuarit që janë shumë të shqetësuar për ndryshimet klimatike, tre shoqatat e para që lidhen me ndryshimet klimatike përfshijnë ngrohjen globale, ndryshimin e shpeshtë të stinëve dhe thatësitrat/përmytjet, terma që ndjekin trendin e përgjithshëm të përgjigjeve nga të gjithë qytetarët e anketuar.


P3. Në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 tregon se nuk jam fare i shqetësuar, dhe 10 tregon se jam shumë i shqetësuar, sa i shqetësuar jeni ju për ndryshimin e klimës?

N=1200




Shumica e qytetarëve pajtohen se ndryshimet klimatike kanë një ndikim negativ në cilësinë e jetës së fëmijëve (40.4 për qind *Shumë negativ* dhe 36.8 *Kryesisht negativ*). Vetëm 15.7 për qind e të anketuarve kanë përgjigje neutrale dhe 3.3 për qind janë përgjigjur kryesisht pozitivisht. Te të moshuarit, për dallim nga ata më të rinjtë, ata me arsim sipëror dhe të anketuarit që jetojnë në mjedise urbane, mendimi më i zakonshëm është se ndryshimet klimatike ndikojnë negativisht në cilësinë e jetës së fëmijëve.

P4. Sipas jush, a do të thoni që ndryshimet klimatike ndikojnë në cilësinë e jetës së fëmijëve? N=1200



Për sa i përket shkakut kryesor të ndryshimeve klimatike, qytetarët shprehin mendime të ndara. Kështu, 43 për qind e të anketuarve besojnë se ndryshimet klimatike shkaktohen kryesisht nga faktorët njerëzorë, ndërsa 39,6 për qind besojnë se ndryshimet klimatike shkaktohet në mënyrë të barabartë nga njeriu dhe natyra. 14.2 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se ndryshimet klimatike janë kryesisht fenomen natyror. Vetëm 1.2 për qind e të anketuarve besojnë se nuk ka ndryshime klimatike. Të dhënat e kryqëzuara tregojnë se, për dallim nga grupet e tjera, gratë, të rinjtë e moshës deri në 29 vjeç, të anketuarit me ose pa arsim fillor dhe shqiptarët etnikë janë përgjigjur se ndryshimet klimatike janë kryesisht fenomen natyror.

### P5. Me cilin nga pohimet e mëposhtme jeni dakord? N=1200




Grupi tjetër i pyetjeve synon ta masë perceptimin e qytetarëve nëse dhe sa ndryshim ka ndodhur për secilin nga fenomenet e mëposhtme në 10 vitet e fundit. Në këtë drejtim, shumica e qytetarëve janë përgjigjur se valët e të nxehtit ndodhin më shpesh në kohën tonë (83 për qind). Zhvendosja e shpeshtë e stinëve, më shumë thatësira, dëmtimi më i shpeshtë i të korrave dhe më shumë zjarre kanë gjithashtu një shkallë reagimi dukshëm të lartë. Nëse e marrim parasysh faktin se studimi është kryer në periudhën e verës, të karakterizuar nga temperatura të larta dhe periudha të thata, si dhe informacionet e intensifikuara në media, ka qenë e pritur që në përgjigje këto dukuri të trajtohen më shpesh se çështjet tjera.

Valët e të ftohtit perceptohen se ndodhin më rrallë se sa që është vlerësuar 10 vite më parë (46 për qind thanë se ndodhin më rrallë), ndërsa mendimet për reshjet janë të ndara (44 për qind thanë se ndodhin më shpesh dhe 43 për qind më rrallë). Tërmetet perceptohen si një fenomen që në përgjithësi ndodh më shpesh se në të kaluarën, megjithatë një përqindje e lartë (27 %) e të anketuarve besojnë se nuk ka ndryshim në intensitetin e këtij fenomeni.

Të dhënat e kryqëzuara për shkallën e urbanizimit të vendbanimit nuk tregojnë dallime të rëndësishme statistikore në asnjë parametër, me përjashtim të shfaqjes së dëmtimit të të korrave të shkaktuara nga insektet ose sëmundjet, që për të anketuarit nga zonat rurale ndodh shumë më shpesh se më parë. Raportime të ndryshme të Shërbimit Hidrometeorologjik dhe Ministrisë së Mjedisit Jetësor për vitet e fundit tregojnë se këto perceptime janë të sakta. Temperaturat mesatare janë rritur, periudhat e thata janë më të gjata, ka më shumë dëmtime të të korrave nga ndryshimet e papritura të temperaturës dhe më shumë zjarre në pyje.



P6. Sipas jush, a ka ndryshuar ndonjë nga fenomenet e mëposhtme në 10 vitet e fundit? N=1200



Pyetja e radhës e këtij grupi, kushtuar njohurive dhe/ose nivelit të informacioneve të të anketuarve, iu referohet pasojave të ndryshimeve klimatike. Përgjigjet e të anketuarve janë spontane dhe janë të mundshme më shumë se një përgjigje.


Thatësiirat janë pasoja kryesore e ndryshimeve klimatike, sipas gati se gjysmës së të anketuarve (51.2 për qind). Ato ndiqen pothuajse në mënyrë të barabartë nga përmbytjet (42.5 për qind) dhe valët e të nxehtit (42.2 për qind). Përgjigjet e radhës – më pak/më shumë reshje – mund të shoqërohen gjithashtu me thatësira përkatësisht përmbytje, madje sipas mendimit të qytetarëve do të ishin pasojat kryesore të ndryshimeve klimatike.

Krahasuar me gjendjen faktike, perceptimi i qytetarëve është i saktë. Sipas raportit<sup>5</sup> për ndryshimet klimatike, Republika e Maqedonisë së Veriut do të përballlet me një klimë më të ngrohtë dhe më të thatë në të ardhmen, që do të thotë se do të ketë rritje të ndodhivë të temperaturave ekstreme të nxehta dhe të atyre ekstreme të ftohta. Analiza tregon se rritja e mundshme e reshjeve ekstreme ditore do të shkaktojë një rrezik më të lartë të përmbytjeve. Nga ana tjetër, zvogëlimi i reshjeve të verës dhe

<sup>5</sup> Raport mbi projeksionet e ndryshimeve klimatike dhe ndryshimet në ndodhtë ekstreme klimatike në REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT nga shkurti i vitit 2020  
[d36c9c7758ecbb9613ce0873796c6dc62d84da6f3dc88da3fdca47b20ec7b94c.pdf](https://www.veriu.mk/d36c9c7758ecbb9613ce0873796c6dc62d84da6f3dc88da3fdca47b20ec7b94c.pdf) (klimatskipromeni.mk)

zgjatja e ditëve të thata do të rrisë rrezikun e thatësisë. Prandaj, si rezultat i kushteve të motit të ngrohtë, periudha mesatare e vegetacionit do të rritet për nga gjatësia.

P7. Sipas jush, cilat janë pasojat e ndryshimeve klimatike? (mund të jepen më shumë përgjigje; përqindja e përgjithshme e tejkalon 100) N=1200



Për shumicën e të anketuarve, aktiviteti i mbjelljes së bimëve dhe pyllëzimit ka ndikimin më të madh në reduktimin e ndryshimeve klimatike (69 për qind – *Ndikon shumë*). Kështu mendojnë të anketuarit që më së shpeshti informohen për ndryshimet klimatike përmes televizorit (46,1 për qind), të ndjekur nga të anketuarit që informohen përmes mediave sociale (36,7 për qind). Mbjellja dhe pyllëzimi pasohen nga pakësimi i konsumit të produkteve në ambalazhe plastike, instalimi i paneleve diellore në shtëpi dhe ndërtesa për prodhimin e energjisë elektrike, instalimi i paneleve diellore për ujin e ngrohtë në qytet dhe rrethinat e tij, përdorimi racional i ujit të pijshëm dhe selektimi/riciklimi i mbeturinave. Këto janë aktivitetet më të theksuara nga të anketuarit, pra më shumë se gjysma e tyre mendojnë se këto aktivitete kanë ndikimin më të madh në zvogëlimin e ndryshimeve klimatike në përgjithësi. Rezultatet tregojnë se qytetarët nuk kanë njohuri të mjaftueshme për shkaqet dhe zgjidhjet e ndryshimeve klimatike, d.m.th., ata i barazojnë ato me aktivitetet që ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet mjedisore, të cilat jo gjithmonë kontribuojnë ndjeshëm në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Aktivitetet, e vlerësuara si dytësore për reduktimin e ndryshimeve klimatike, d.m.th., aktivitetet pa ndonjë ndikim të madh, përfshijnë: dhurimin e rrobave (23 për qind – Nuk ndikon fare në ndryshimin e klimës), digjitalizimi i operacioneve (11 për qind – Nuk ndikon fare në ndryshimin e klimës), më pak udhëtim ajror (10 për qind – Nuk ndikon fare në ndryshimin e klimës) dhe përdorimi i drurit për ngrohje (9 për qind – Nuk ndikon fare në ndryshimin e klimës).


Analiza shpie në përfundimin se qytetarët reagojnë ose u kushtojnë më shumë rëndësi koncepteve (aktiviteteve) që kanë një kuptim ose veprim specifik (për shembull:

pyllëzimi, reduktimi i konsumit, përzgjedhja e mbeturinave) sesa koncepteve që nuk i nënkuptojnë drejtpërdrejt veprimet e nevojshme për zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Ky grup pyetjesh do t'i nënshtrohet me tej një analize adekuate shtesë në rubrikën *Praktikat e qytetarëve*, ku do të krahasojmë nëse aktivitetet personale të qytetarëve e ndjekin trendin e rezultateve që i komentuar më lart.

P8. Sipas njohurive tuaja, në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 tregon "Ndikon shumë" dhe 5 tregon se "Nuk ndikon fare", në çfarë mase secili nga aktivitetet e mëposhtme ndikon në

## zbutjen e ndryshimeve klimatike? N=1200




Dy pyetjet e mëposhtme i matin perceptimet e publikut për ujin e pijshëm dhe cilësinë e ajrit në përgjithësi, krahasuar me periudhën 10 vjet më parë. Këto pikëpamje zakonisht bazohen në memorien e të anketuarve, por edhe në informacionet që ata i marrin nga kanale të ndryshme të raportimit (kjo është veçanërisht e vërtetë për kategorinë më të re të të anketuarve).

Sa i përket cilësisë së ujit, vetëm 6.2 për qind mendojnë se është përmirësuar, 38.7 për qind mendojnë se nuk ka ndryshuar dukshëm, ndërsa shumica (50.7 për qind) mendojnë se në 10 vitet e fundit cilësia e ujit të pijshëm është përkeqësuar. Sa i përket cilësisë së ajrit, shtatë në dhjetë qytetarë mendojnë se është përkeqësuar në dhjetë vitet e fundit, kundrejt 22.8 për qind që mendojnë se nuk ka ndryshuar dukshëm dhe vetëm 4.2 për qind mendojnë se është përmirësuar.

Përgjigja më e përhapur në pyetjen “Çfarë mendoni se kontribuon më shumë në ndryshimin e klimës?” është industria, e dhënë nga shumica e të anketuarve (66.1 për qind). Më pas vijojnë transporti dhe trafiku (44.4 për qind), djegia e mbeturinave në deponitë ilegale (40.1 për qind) dhe ngrohja e amvisërive me energji jo-mjedisore (37.8 për qind). Energjia si një kontribuues në ndryshimet klimatike përmendet drejtpërdrejt në 17.7 për qind të rasteve. Në fakt, është sektori<sup>6</sup> i energjisë që liron më shumë gazra serë, që do të ishte përgjigja më e saktë nga të gjitha përgjigjet e ofruara. Megjithatë, sipas njohurive shkencore, mund të konkludohet se sektori i energjisë bie nën sferën e industrisë dhe ai është vendimtar për ndryshimet klimatike, gjë që e shpjegon perceptimin e qytetarëve.

Industria dominon më shumë në përgjigjet e dhëna nga të anketuarit me arsim sipëror në krahasim me të anketuarit me arsim fillor ose pa arsim, të anketuarit që jetojnë në mjediset urbane, maqedonasit etnik dhe të anketuarit me të ardhura mujore më të larta. Për dallim nga kjo, djegia e mbeturinave në deponitë ilegale është më e theksuar në përgjigjet e dhëna nga të anketuarit me arsim fillor të përfunduar, shqiptarët etnikë dhe të anketuarit me të ardhura mujore nën mesataren krahasuar me kategoritë e tjera të anketuar.

P11. Çfarë mendoni se kontribuon më shumë në ndryshimet klimatike?  
(mund të jepen më shumë përgjigje) N=1200




Grupit të ardhshëm të pyetjeve i përgjigjen vetëm të anketuarit që besojnë se ngrohja e amvisërive me energji jo-mjedisore kontribuon në ndryshimet klimatike dhe synon të përcaktojë se cilat burime energjie të përdorura për ngrohjen e shtëpive ndikojnë më shumë në ndotjen e ajrit. Sipas të anketuarve, qymyri (74 për qind) dhe mbetjet e ndryshme (79 për qind) janë burimet e energjisë që kanë ndikimin më të madh në ndotjen e ajrit. Ato pasohen nga nafta dhe drutë (për djegie) si burime energjie që kanë një ndikim mesatar në ndotjen e ajrit.

<sup>6</sup> Nga vijnë emetimet e gazeve serrë në sektor [Opst\\_MK \(klimatskipromeni.mk\)](http://Opst_MK(klimatskipromeni.mk))

Dielli është një burim energjie që shumica dërrmuese e të anketuarve besojnë se nuk kontribuon në ndotjen (83 për qind – *Nuk ndikon aspak*), i ndjekur nga gazi, prej të cilit 63 për qind e të anketuarve thanë se *Nuk ndikon aspak në ndotjen e ajrit*. Këto të dhëna tregojnë njohuri të pamjaftueshme për ndryshimet klimatike, pasi gazi është lëndë djegëse fosile, që ndikon edhe në ndotjen e ajrit, por që kontribuon edhe më shumë në ndryshimet klimatike. Sa iu përket peleteve, edhe pse mbizotëron mendimi se nuk ndikojnë në ndotjen e ajrit, megjithatë është e konsiderueshme përqindja e të anketuarve (22 për qind) që e mendojnë të kundërtën.

P14. Në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 tregon “Nuk ndikon aspak” dhe 10 “Ndikon shumë”, në çfarë mase ndikon në ndotjen e ajrit secili nga burimet e shënuara të energjisë, që përdoren për ngrohjen e amvisërisë?

(Të përgjigjet vetëm nga të anketuarit që mendojnë se ngrohja e amvisërisë me burime jo-mjedisore të energjisë kontribuon në ndryshimet klimatike) N=453




Në pyetjen “Sipas njohurive tuaja, cili nga gazrat e mëposhtëm kontribuon në ndryshimin e klimës?” janë të ndara mendimet e qytetarëve. Gjysma e të anketuarve janë përgjigjur se është dyoksidi i karbonit (53.1 për qind) dhe po aq (51.1 për qind) janë përgjigjur se janë grimcat PM10. Kjo virtualisht na tregon se këto dy përgjigje përsëriten kryesisht nga të gjithë të anketuarit. Rezultatet e kryqëzuara tregojnë se të rinjtë e moshës 15-18 vjeçare e bëjnë dallimin midis ndotjes së ajrit dhe ndryshimeve klimatike, pasi reagimi i grimcave PM10 është dukshëm më pak i përfaqësuar në krahasim me kategoritë e tjera të të anketuarve.

Përfundimi i përgjithshëm është se të anketuarit nuk bëjnë dallime ndërmjet ndotjes së ajrit dhe ndryshimeve klimatike, d.m.th., ata i shtrojnë të dyja këto çështje brenda konceptit më të gjerë të mjedisit dhe/ose ekologjisë.



P12. Sipas njohurive tuaja, cili nga gazrat e mëposhtëm kontribuon në ndryshimin e klimës? (mund të jepen më shumë përgjigje) N=1200



#### 4. Qëndrimet ndaj ndryshimeve klimatike dhe ndikimi i tyre ndaj mjedisit

Pjesa e dytë i këtij hulumtimi përbëhet nga disa grupe pyetjesh që synojnë t'i matin pikëpamjet e qytetarëve për aspekte të ndryshme, të cilat ndërlidhen me ndryshimet klimatike dhe mjedisin:

- A. Pikëpamjet dhe stereotipat për ndryshimet klimatike;
- B. Pikëpamjet mbi zgjidhjet e mundshme për zbutjen e ndryshimeve klimatike;
- C. Qëndrimet që e përcaktojnë veprimin shoqëror;

Deklaratat u krijuan në mënyrë që t'i vëzhgonin opinionet e qytetarëve përmes një sërë parametrash të ndryshëm, duke filluar nga stereotipat dhe paragjykimet për këtë temë, deri te niveli i pranimit të disa zgjidhjeve të mundshme për zbutjen e ndryshimeve klimatike.


Krahas analizës klasike dhe interpretimit të rezultateve, kjo pjesë do ta përfshijë një analizë shtesë, ndërsa qëndrimet do të interpretohen përmes qasjes së kanaleve më të zakonshme të informacioneve për ndryshimet klimatike, të përdorura nga të anketuarit (televizioni dhe mediat sociale) në rastet kur shfaqen dallime të rëndësishme statistikore.

Në fillim të kësaj pjese, qytetarëve iu kërkua që fillimisht t'i theksonin tre çështjet mjedisore që i shqetësojnë më shumë. Analiza tregoi se qytetarët janë padyshim dhe më së shumti të shqetësuar për ndotjen e ajrit, përgjigje kjo e dhënë nga 62 për qind e të anketuarve. Megjithatë, ky rezultat nuk duhet të jetë befasues, sepse ndotja në vendin tonë është një problem alarmant, për disa dekada dhe një temë dominuese për publikun e gjerë dhe mediat, veçanërisht gjatë muajve të dimrit, kur për disa vite me radhë vendi ka një nivel rekord të ajrit të ndotur. Nga analiza krahasuese mes grupeve rezultoi se gratë dhe të rinjtë deri në moshën 29 vjeçare janë dy kategoritë e

qytetarëve që janë veçanërisht të shqetësuar për ndotjen e ajrit në krahasim me grupet e tjera.

Dy problemet e radhës të renditura më lart janë ndotja e deteve, liqeneve dhe lumenjve (27.6 për qind) dhe thatësitrat (26.6 për qind). Qytetarët shprehën shqetësim më të madh edhe për ushqimet organike të modifikuara (OMGJ)<sup>7</sup>, deponitë ilegale dhe mbetjet radioaktive, ndërsa më pak të shqetësuar ishin për mbipopullimin dhe zhdukjen e florës dhe faunës. Ajo që është e rëndësishme të theksohet nga pikëpamja e komunikimit është se këto rezultate tregojnë përsëri se njerëzit përgjithësisht iu përgjigjen termave dhe koncepteve që janë të afërta dhe të dukshme për ta, në krahasim me konceptet abstrakte ose problemet që nënkuptojnë pasoja në të ardhmen e largët.

P15. Zgjedhni tre çështjet, që ju shqetësojnë më së shumti:  
(mund të jepen deri në tre përgjigje) N=1200



#### 4.1. Pikëpamjet dhe stereotipat për ndryshimin e klimës

<sup>7</sup> Organizmat e modifikuar gjenetikisht/Ushqimi i modifikuar gjenetikisht

Ky grup i pyetjeve synon t'i eksplorojë bindjet e të anketuarve rreth ndryshimeve klimatike. Përgjigjet e të anketuarve maten duke përdorur një shkallë të marrëveshjes me katër pikë në lidhje me secilën nga pohimet.

*Ndryshimet klimatike do ta ulin cilësinë e jetës për brezat e ardhshëm* është pohimi me të cilën shumica dërrmuese e të anketuarve pajtohen më së shumti (46 për qind pajtohen plotësisht, 35 për qind pajtohen në përgjithësi). Pohimi, i cili e arrin një praninë të madh pas këtij është *Ndryshimi i klimës dhe ngrohja globale janë e njëjta gjë* (32 për qind pajtohen plotësisht, ndërsa 41 për qind pajtohen në përgjithësi). Është mjaft interesante se të anketuarit të cilët më së shumti informohen për këtë temë përmes mediave sociale kanë shprehur mospajtim më të madh me këtë deklaratë sesa të anketuarit që informohen përmes televizorit. Të rinjtë janë një kategori e qytetarëve të cilët po ashtu kanë shprehur mospajtim më të madh në krahasim me kategoritë e tjera të qytetarëve, por edhe ky grup ka shprehur mospajtim më të madh me pohimin se ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale janë e njëjta gjë. Për më tepër, më shumë se gjysma e qytetarëve pajtohen se *njerëzit që jetojnë në qytete shkaktajnë më shumë ndotje se njerëzit që jetojnë në fshat*, pohim me të cilën pajtohen praktikisht të gjithë të anketuarit, pavarësisht nëse jetojnë në mjedise urbane ose rurale. Njerëzit në përgjithësi janë pesimistë, duke deklaruar se *vendet e varfra mund të bëjnë pak për t'i zbutur ndryshimet klimatike*, megjithëse ka një numër të konsiderueshëm të të anketuarve që nuk pajtohen me këtë (të anketuarit nën moshën 29 vjeçare, ata me arsim sipëror, të anketuarit me të ardhura mujore mbi 40,000 denarë). Të anketuarit shprehin mendime të ndara në lidhje me pohimin se *të mbijetosh sot është shumë më e rëndësishme sesa të shqetësohesh për atë që do ta sjellë e ardhmja*. Me këtë pohim më shumë pajtohen meshkujt sesa femrat, gjegjësisht të rinjtë më shumë se të moshuarit dhe qytetarët me të ardhura mujore deri në 18.000 denarë.

Qytetarët nuk pajtohen me pohimin se ndryshimet klimatike nuk ndikojnë në vendin tonë – 54 për qind e të anketuarve nuk pajtohen plotësisht me këtë pohim, ndërsa 26 për qind në përgjithësi nuk pajtohen. Këto të dhëna tregojnë se besimi i përgjithshëm i publikut është se Maqedonia e Veriut është e prekur nga ndryshimet klimatike. Gjithashtu, në këtë drejtim, shumica e qytetarëve nuk pajtohen se *ndryshimet klimatike do ta përmirësojnë klimën në vendin e tyre* (44 për qind nuk pajtohen plotësisht, 29 për qind nuk pajtohen në përgjithësi).

Sa i përket qëndrimeve lidhur me dietën, mbizotëron mendimi se vegjetarianët ushqehen shëndetshëm, ku vetëm 10 për qind e të anketuarve nuk pajtohen fuqishëm me këtë pohim (ky është mendimi i të anketuarve mbi 65 vjeç me ose pa arsim fillor). Në këtë drejtim, shumica e të anketuarve janë të mendimit se *mishi nuk është i nevojshëm për të mbijetuar*, ndërsa vetëm 14 për qind nuk pajtohen me këtë pohim (ky është mendimi i të anketuarve mbi 65 vjeç, me shkollë fillore ose pa arsim dhe të anketuarve që jetojnë në zonat rurale).

16. Ju lutemi tregoni se sa jeni dakord me secilin nga pohimet e mëposhtme:

N=1200




Tabela e mëposhtme mund të përdoret për t'i analizuar qëndrimet individuale të qytetarëve në varësi të kanalit të informacionit që ata përdorin më shpesh për t'u informuar mbi temën. Këto rezultate janë paraqitur për të treguar se burimet të ndryshme të informacioneve ka të ngjarë të krijojnë dallime në pikëpamjet e të anketuarve; megjithatë, këto rezultate nuk priren të nxjerrin përfundime të përgjithshme në lidhje me pikëpamjet e të anketuarve si të tilla.

P16/P34. Dallimet e rëndësishme në disa nga pikëpamjet e të anketuarve bazuar në burimin e tyre kryesor të informacionit

		Si informoheni zakonisht për ndryshimet klimatike dhe mjedisin?		
Pohimet	Pikat ekstreme	TV	Media sociale	Dallimi
Njerëzit duhet të hanë mish për të mbijetuar.	Plotësisht pajtohem	14 për qind	12 për qind	-2 për qind
	Plotësisht nuk pajtohem	26 për qind	34 për qind	8 për qind
Vegjetarianët nuk ushqehen shëndetshëm.	Plotësisht pajtohem	11 për qind	6 për qind	-6 për qind

	Plotësisht nuk pajtohem	28 për qind	41 për qind	12 për qind
Njerëzit që jetojnë në qytete shkaktajnë më shumë ndotje se njerëzit që jetojnë në fshat.	Plotësisht pajtohem	31 për qind	26 për qind	-4 për qind
	Plotësisht nuk pajtohem	11 për qind	20 për qind	9 për qind
Vendet e varfra mund të bëjnë pak për t'i zbutur ndryshimet klimatike.	Plotësisht pajtohem	29 për qind	23 për qind	-6 për qind
	Plotësisht nuk pajtohem	13 për qind	17 për qind	4 për qind
Ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale janë e njëjta gjë.	Plotësisht pajtohem	36 për qind	26 për qind	-10 për qind
	Plotësisht nuk pajtohem	5 për qind	16 për qind	10 për qind
Ndryshimet klimatike nuk ndikojnë në vendin tonë.	Plotësisht pajtohem	8 për qind	7 për qind	-1 për qind
	Plotësisht nuk pajtohem	48 për qind	62 për qind	14 për qind
Energjia e rinovueshme fitohet vetëm kur moti është me re ose me erë.	Plotësisht pajtohem	11 për qind	9 për qind	-2 për qind
	Plotësisht nuk pajtohem	16 për qind	31 për qind	15 për qind
Ndryshimi i klimës është vullneti i Zotit.	Plotësisht pajtohem	15 për qind	13 për qind	-2 për qind
	Plotësisht nuk pajtohem	27 për qind	43 për qind	17 për qind


#### 4.2. Pikëpamjet mbi zgjidhjet e mundshme për t'i zvogëluar ndryshimet klimatike

Në grupin tjetër të deklaratave që i referohen zgjidhjeve potencialisht të pranueshme për zbutjen e ndryshimeve klimatike, qytetarët pajtohen me shumë pika, siç tregohet në grafikun e mëposhtëm. Shumica pajtohen se *impiantet e djegies së mbetjeve paraqesin rrezik për ndotjen e mjedisit*, një opinion që e kanë 88 për qind e qytetarëve të anketuar. Gjithashtu, 86 për qind e qytetarëve vlerësojnë se *energjia diellore është një zgjidhje për ndotjen e ajrit*. Megjithëse ekzistenca e impianteve të djegies së mbetjeve nuk do të thotë domosdoshmërisht edhe ndotje e mjedisit, mosbesimi i përgjithshëm dhe i kahershëm i publikut për çështjen nëse industria e rëndë funksionon sipas standardeve të sigurta për mjedisin, së bashku me dështimin e institucioneve për ta ngritur mekanizmin e kontrollit, rregullimit dhe sanksionimit, kontribuoi padyshim në këtë pikëpamje të shprehur fuqishëm dhe të qartë të qytetarëve.

Qytetarët shprehën mospajtimin më të madh me pohimin se *është e kotë të seleksionohen mbeturinat, kur të gjitha ato përfundojnë në të njëjtin vend* (18 për qind nuk pajtohen plotësisht, 23 për qind kryesisht nuk pajtohen), megjithëse për një masë të lartë (32 për qind e të anketuarve), përzgjedhja e mbetjeve është me të vërtetë e padobishme. *Përdorimi i lumenjve për prodhimin e energjisë elektrike* është një zgjidhje me të cilën nuk pajtohen 25 për qind e të anketuarve.

## P17. Ju lutemi tregoni se sa jeni dakord me secilën nga pohimet e mëposhtme:

N=1200



### 4.3. Qëndrimet që e përcaktojnë veprimin shoqëror

Grupi i tretë i qëndrimeve dhe perceptimeve i mbulon temat, që e përcaktojnë veprimin shoqëror. Ajo që mund të nxirret si përfundim i përgjithshëm është se pikëpamjet e të anketuarve ndryshojnë kryesisht në lidhje me mospajtimet.

Nëntë nga dhjetë qytetarë pajtohen pothuajse në mënyrë të barabartë se arsimi dhe edukimi kontribuojnë në shprehitë e shëndosha mjedisore dhe ndërgjegjësimin mjedisor. *Ky është një tregues i fortë se publiku është i vetëdijshëm për rolin e familjes si një faktor kontribuues në krijimin e shprehive të njerëzve për mjedisin, por edhe se shkolla është vendi më i mirë për ta zhvilluar ndërgjegjësimin e fëmijëve për këtë temë. Investimi në inovacionin teknologjik për të trajtuar ndryshimet klimatike është deklarata e tretë me më shumë pajtueshmëri. Nëse i shikojmë këto deklarata përmes përgjigjeve të të anketuarve që besojnë se individët nuk mund të ndikojnë në ndryshimin klimatik, të dhënat tregojnë se 91 për qind e këtij grupi të anketuarve (N=241) pajtohen me pohimin se edukimi familjar kontribuon në zakonet mjedisore dhe ndërgjegjësimin për ndryshimet klimatike, ndërsa një për qindje e barabartë beson se shkolla kontribuon në*



krijimin e këtyre shprehive. Pohimet ekstreme (pajtohem plotësisht) tregojnë se ky grup i të anketuarve i jep më shumë përparësi edukimit sesa arsimit.


Duhet nënvizuar faktin, që qytetarët e konsiderojnë ndryshimin e klimës si një problem real, që ndodh aktualisht. Ata gjithashtu nuk besojnë se natyra është mjaft e fortë për t'u përballur me ndikimet negative të shkaktuara nga njeriu, as nuk pajtohen me pikëpamjen se njerëzit kanë të drejtë ta ndryshojnë mjedisin sipas nevojave të tyre. Megjithatë, këto pikëpamje ka të ngjarë të bien nën kategorinë e përgjigjeve të pranueshme nga shoqëria, prandaj, ato duhet të analizohen së bashku me pikëpamjet që e përcaktojnë nivelin e gatishmërisë për veprim individual, si dhe pikëpamjet që ndërlidhen me stabilitetin ekonomik dhe jetesën e personit të anketuar.

Për shembull, deri në 43 për qind e të anketuarve nuk pajtohen se si individë mund të ndikojnë në ndryshimet klimatike, madje pothuajse gjysma e tyre *do të ndërmerrnin veprime vetëm kur të tjerët rreth tyre ta kenë bërë të njëjtin veprim*. Për më tepër, 35 për qind e të anketuarve *pajtohen me pohimin “punoj për të siguruar jetesën, edhe nëse është në dëm të mjedisit”*. Rreth 29 për qind e të anketuarve besojnë se *rritja e ekonomisë lidhet me dëmet e shkaktuara në mjedis*.

Në fakt, këto të dhëna, së bashku me pyetjen fillestare për problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët, duhet të jenë pikënisje në interpretimin dhe kuptimin e të gjitha pikëpamjeve të tjera, sepse e tregojnë qartë motivin, potencialin dhe shtytësin për çdo veprim shoqëror në përgjithësi.

P18. Ju lutemi tregoni se sa jeni dakord me secilën nga pikëpamjet e mëposhtme:

N=1200




## 5. Perceptimi i përgjegjësisë dhe veprimi institucional

Kjo pjesë e hulumtimit synon ta përcaktojë përgjegjësinë, domethënë kontributin që duhet të japë secili prej subjekteve të ndryshme, që punojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike. Sipas shumicës së të anketuarve, të cilët e kanë këtë bindje në 66.8 për qind të rasteve, përgjegjësia më e madhe qëndron te çdo qytetar individual, pikëpamje e hasur më shpesh nga të anketuarit më të rinj të moshës 15-18 vjeçare, për dallim nga më të moshuarit, dhe më shumë e pohuar nga gratë se nga burrat, si dhe më shumë nga shqiptarët etnikë sesa nga maqedonasit etnik. Në 58 për qind të rasteve, të anketuarit e kanë potencuar Qeverinë, ndërsa industria e biznesit është shënuar si më përgjegjëse në 47.2 për qind të rasteve. Fuqitë e mëdha botërore konsiderohen si më përgjegjëse për zgjidhjen e këtyre problemeve në 45.4 për qind të rasteve, ndërsa autoritetet lokale konsiderohen më përgjegjëse në 34.5 për qind të rasteve. Përgjegjësia e organizatave ndërkombëtare për zgjidhjen e këtyre problemeve është theksuar në 19.2 për qind të rasteve.

Edhe pse përgjegjësia e Qeverisë renditet si e dyta, shumica e të anketuarve (40.5 për qind) nuk dhanë përgjigje për pyetjen e hapur “Çfarë mendoni se duhet të bëjë qeveria për t’i trajtuar ndryshimet klimatike dhe për ta mbrojtur mjedisin?” Ajo që qytetarët mendojnë se duhet të bëhet nga Qeveria mund të ndahet në tre grupe. Grupi i parë i përfshin masat dhe sanksionet: më shumë masa për mbrojtjen e mjedisit (9.2 për qind) dhe dënime për ata që e ndotin mjedisin (9.8 për qind). Grupi i dytë përfshin të anketuarit që mendojnë se pyllëzimi (5.5 për qind) është mënyra e duhur për qeverinë, që të përballet me këto probleme, ndërsa grupi i tretë i përfshin subvencionet për panelet diellore dhe kolektorët (5.3 për qind), transportin ekologjik (3.5 për qind) dhe gazifikimin (3 për qind) si disa nga gjërat që do të kontribuonin në zgjidhjen e këtyre problemeve. Rreth 2.5 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se Qeveria duhet të përpiqet, që ta edukojë popullatën për këto çështje dhe rreth 1.2 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se duhet të punohet në sensibilizimin e popullatës.


P20. Çfarë mendoni se duhet të bëjë qeveria për t'i trajtuar ndryshimet klimatike dhe për të ruajtur mjedisin? N=1200



## 6. Praktikave të qytetarëve

Pjesa e tretë e këtij hulumtimi e trajton temën e praktikave të qytetarëve në lidhje me mjedisin. Rezultatet tregojnë se pothuajse gjashtë në dhjetë qytetarë nuk e kanë ndërmarrë ndonjë veprim specifik për mbrojtjen e mjedisit. Vetëm 18.6 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se ata personalisht kanë ndërmarrë veprime, ndërsa 7.3 për qind janë përgjigjur se dikush që e njohin e ka bërë atë veprim. Kategoria më aktive të qytetarëve ,që kanë ndërmarrë veprime personalisht, janë të anketuarit e moshës 15-18 vjeçare, ndonëse më shpesh të anketuarit meshkuj sesa ato femra. Të anketuarit, që e kanë mbaruar arsimin e sipëror, të cilët jetojnë në një mjedis urban dhe kanë të ardhura mujore më të larta se kategoritë e tjera të qytetarëve, janë shprehur se kanë ndërmarrë veprime të posaçme. Më së shpeshti, qytetarët angazhohen në veprimet e mëposhtme për ta mbrojtur mjedisin: selektimi i mbeturinave (22 për qind), pastrimi i hapësirave publike (12 për qind), kalimi në pajisjet e ngrohjes dhe ftohjes së mjedisit (9 për qind) dhe pyllëzimi (8 për qind).

P21. A keni ndërmarrë ju personalisht ose dikush që njihni veprime të posaçme për ta mbrojtur mjedisin? N=1200




Përmes grupit vijues të pyetjeve, i matim praktikatat e qytetarëve në lidhje me aktivitetet, që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi. Në këtë rast, aktivitetet më të praktikuara janë ecja (35 për qind rregullisht), përdorimi racional i ujit (34 për qind rregullisht) dhe përdorimi i llambave me efikasitet energjetik në shtëpi (39 për qind rregullisht).

15 për qind e të anketuarve konsumojnë rregullisht ushqim organik dhe po aq nuk konsumojnë fare ushqim organik. 28 për qind e të anketuarve përdorin rregullisht dru për ngrohje, ndërsa 35 për qind nuk i përdorin aspak.

Më shumë se gjysma e të anketuarve janë përgjigjur se nuk praktikojnë fare udhëtime ajrore. Një shpjegim i mundshëm i mungesës së praktikimit të këtij aktiviteti lidhet me pamundësinë për ta përballuar blerjen biletave të avionit, ndalesat për udhëtime dhe/ose kushtet e vështira të udhëtimit për shkak të pandemisë Kovid-19, në vend të mos praktikimit të aktivitetit për hir të mbrojtjes së mjedisit jetësor. Më tej, 47 për qind e qytetarëve nuk kanë bërë kurrë kompostim dhe pothuajse po aq (44 për qind) nuk kanë kultivuar asnjëherë perime apo fruta për nevojat e tyre. Pritet që të ketë dallime të rëndësishme statistikore në përgjigjet që kanë të bëjnë me këto dy aktivitete midis të anketuarve që jetojnë në mjediset rurale dhe atyre që jetojnë në mjediset urbane.

Lidhur me aktivitetet e vlerësuara në grafikun e mëposhtëm, është e nevojshme të theksohet se disa prej tyre varen vetëm nga dëshira dhe ndërgjegjësimi i individit, mirëpo disa tjera varen edhe nga kushtet (mjedisi i jetesës) dhe mundësitë. Kështu, për shembull, përdorimi i transportit publik është një opsion vetëm për të anketuarit, komunat e të cilëve ofrojnë një shërbim të tillë, çiklizmi/skuterët si aktivitet varet nga infrastruktura e një komune ose mjedisi të caktuar, dhe në mënyrë të ngjashme, përzgjedhja e mbeturinave është e ndërlidhur me ekzistencën e një shërbimi të veçantë të koshave për këtë qëllim. Ky konstatim është në përputhje me konkluzionin se, përveç nevojës për ndërgjegjësimin e qytetarëve për aktivitete të caktuara, kërkohet edhe një përkushtim shumë më i madh institucional, e rrjedhimisht edhe social për të mundësuar dhe inkurajuar disa aktivitete në mënyrë që ato të bëhen praktikë e rregullt e shoqërisë në tërësi.


P23. Sa shpesh i praktikoni aktivitetet e mëposhtme? N=1200



Analiza e mëposhtme i krahason aktivitetet, të cilat qytetarët i kanë shënuar si më me ndikim në zvogëlimin e ndryshimeve klimatike dhe aktivitetet më të zakonshme të praktikuar aktualisht nga qytetarët. Të dhënat në grafikun e mëposhtëm tregojnë qartë se qytetarët nuk i praktikojnë rregullisht aktivitetet, që ata i kanë identifikuar si kyçe për zvogëlimin e ndryshimeve klimatike. Kjo tregon se megjithëse qytetarët janë përgjithësisht të informuar se si mund të ndihmojnë personalisht në zbutjen e këtij problemi global, megjithatë rezultatet e analizave të parashtruara më sipër sugjerojnë se motivimi individual dhe gatishmëria për të ndërmarrë çdo veprim është në një nivel të palakmueshëm.




P22 me 23. Sipas njohurive tuaja, cilat nga aktivitetet e mëposhtme kanë ndikimin më të madh në zvogëlimin e ndryshimeve klimatike dhe a i praktikoni rregullisht ato?  
*N=1200 (Përgjigjet e të anketuarve: praktikimi i rregullt i aktiviteteve ndërlidhet me ato aktivitete, që kanë ndikimin më të madh në zvogëlimin e ndryshimeve klimatike)*



Qytetarët janë të ndarë mbi gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar në aktivitete për mbrojtjen e mjedisit. Kur u pyetën: “Sa jeni personalisht të përgatitur (motivuar) për t'u përfshirë në veprime për mbrojtjen e mjedisit?” 19.3 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se janë shumë të motivuar, kurse 26.8 për qind janë disi të motivuar. Motivim më i madh është shprehur nga të anketuarit më të rinj të moshës 18-29 vjeçare dhe të anketuarit me arsim sipëror, për dallim nga të anketuarit me arsim fillor, të cilët motivimi është dukshëm më i ulët. E njëjta vlen edhe te të anketuarit, që jetojnë në zona urbane, për dallim nga të anketuarit që jetojnë në zonat rurale.

P25. Sa jeni personalisht të gatshëm (motivuar) të angazhoheni në veprime për mjedisin? *N=1200*



Nga të anketuarit që thanë se kanë qenë të gatshëm të përfshiheshin në aktivitete mjedisore, shumica prej tyre u përgjigjën se do ta bënin këtë për një jetë më të mirë për brezat e ardhshëm (25.4 për qind)ë për shkak të dashurisë së tyre për bimët dhe kafshët (22, 8 për qind); për shkak të bindjeve personale (20.4 për qind) dhe për qëllime të zgjidhjes së një problemi apo nevoje të posaçme (11.9 për qind). Nga krahasimi i përgjigjeve të grupeve të ndryshme të qytetarëve në bazë të faktorëve demografikë, nuk u konstatuan dallime të rëndësishme statistikore.


P26. Çfarë ju nxit/motivon të përfshiheni në veprimet mjedisore? *N=554*



Kur u pyetën për arsyen kryesore që e kanë këtë qëndrim, të anketuarit që nuk ishin të gatshëm të angazhohen në këto aktivitete deklaruan se ishte humbje kohe dhe se ata vetë nuk mund të ndryshonin asgjë (32.6 për qind), ndërsa pothuajse po aq (33.6 për qind) besojnë se ajo nuk i shqetëson për momentin, që do të thotë se është punë e dikujt tjetër.

Mostra e këtij nëngrupi është shumë e vogël për të nxjerrë dallime të rëndësishme statistikore, mirëpo ia vlen të realizohet observimi i mëposhtëm. **Me përjashtim të kategorisë më të vjetër të qytetarëve të moshës 65 vjeç e më lart, të dhënat e kryqëzuara të këtij grupi të të anketuarve që nuk janë të gatshëm të angazhohen në veprime mjedisore janë veçanërisht befasuese. Domethënë, ajo që bie në sy është homogjeniteti i përgjigjeve ndërmjet grupeve, që praktikisht do të nënkuptonte se mosmotivimi i qytetarëve nuk vjen nga dallimet që kanë njerëzit për sa i përket gjinisë, moshës, mjedisit të banimit apo të ardhurave, por arsyeja pse kjo mund të jetë shumë më e thellë, është rezultat i bazës strukturore dhe sociale.**

P27. Cila është arsyeja kryesore pse nuk jeni të gatshëm të angazhoheni në veprime mjedisore? N=599



## 7. Mediat dhe burimet e informimit

Opinionin publik në vend e formojnë mbi 10 televizione në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe me koncesione nacional, të cilët për çdo ditë informojnë dhe organizojnë debate për çështjet më aktuale. Ka shumë radio stacione, mbi 250 portale të internetit dhe mbi një milion profile në rrjetet sociale si Fejsbuk, Tuitet, Instagram etj.


Televizioni mbetet mediumi më me ndikim në Maqedoni, i ndjekur rregullisht nga 66 për qind e të anketuarve. Rrjetet sociale janë pjesë e përditshmërisë për 55 për qind të qytetarëve, një përqindje që rritet ndjeshëm nga viti në vit.

Pavarësisht rritjes së numrit të platformave dhe teknologjive të ndryshme të komunikimit, sipas rezultateve të sondazhit, televizioni e ruan pozicionin e tij si burimi më i zakonshëm i informimit. Duke qenë i disponueshëm gjerësisht dhe tashmë i integruar në zakonet e përditshme, ky medium mbetet lloji i mediumit më me ndikim për të anketuarit. Të anketuarit i besojnë më së shumti Televizionit Sitel (17,5 për qind), Kanal 5 (16,9 për qind), Alsat M (13,8 për qind) dhe Televizionit Telma (9,5 për qind). Rreth 10 për qind e të anketuarve thanë se nuk i besonin asnjë kanali televiziv.

Nga ana tjetër burimet e informacioneve në internet (onlajn) ndahen në faqet e internetit dhe mediat sociale, megjithëse në praktikë ato veprojnë si burime të ndërlidhura informacionin, p.sh., rrjetet sociale zakonisht i përdorin faqet e internetit si burimin e tyre kryesor për ta ripostuar më pas informacionin e tyre në platformat e tyre dhe kanalet e komunikimit. Megjithatë, ky proces mund të jetë edhe anasjelltas, ku portalet e internetit i përdorin mediat sociale si burime të lajmeve.


Përdorimi i mediave të shkruar, gazetave ditore dhe javore si burim informimi është në ngecje ose në rënie.

P31. Sa shpesh i përdorni këto media/kanale për të marrë informacione? N=1200



Nga të anketuarit që informohen rregullisht përmes televizionit, popullsia e moshës 65+ është përfaqësuar me përqindje më të lartë (96%). Në të njëjtën kohë, me rënie e moshës, kjo përqindje zvogëlohet, ku të anketuarit më të rinj të moshës 15-18 vjeçare dhe 19-29 vjeçare informohen më së paku përmes televizionit.

P31 me P2.3 Sa shpesh e përdorni televizionin për të marrë informacione?




Një përqindje e lartë (42.7 %) e të anketuarve në 6 muajt e fundit e kanë vënë re se ndryshimet klimatike dhe temat e ndërlidhura me mjedisin kishin fituar rëndësi në

media, ndërsa 50.6 për qind u përgjigjën negativisht në këtë pyetjeje. Dy burimet dominuese të informacioneve mbi ndryshimet klimatike dhe mjedisin janë televizioni (46.5 për qind) dhe mediat sociale (35.6 për qind). Rreth 7 për qind e të anketuarve informohen për këto tema përmes ueb portaleve/faqeve të posaçme.

P34. Zakonisht ku merrni informacione për ndryshimet klimatike dhe mjedisin?

N=1200



## 8. Metodologjia e hulumtimit

Për realizimin e këtij studimi është përdorur metodologjia sasiore e kërkimit. Teknika e grumbullimit të të dhënave konsistonte në kryerjen e një interviste ballë për ballë me të anketuarit në shtëpitë e tyre. Me qëllim të përmbushjes së objektivave të hulumtimit u përgatit një pyetësor me rreth 120 variabla (pyetje) të kombinuar të tipit të mbyllur dhe të hapur.

Për qëllimet e këtij hulumtimi, u përdor një metodologji kërkimore sasiore e një mostre reprezentative të shtresuar në shumë nivele. Sipas strukturës gjeo-demografike të popullsisë së saj, Maqedonia e Veriut ndahet në tetë rajone: Shkupi, Pollogu, Pellagonia, Vardari, Rajoni Verilindor, Juglindor, Jugperëndimor dhe Lindor, si dhe në bashkësi urbane dhe rurale. Numri i të anketuarve ishte në përpjesëtim me numrin e përgjithshëm të popullsisë në secilin rajon.

Mostra kryesore përmbante 1200 familje; Çdo familje përfaqësohej nga një i anketuar i moshës 15+.

Hulumtimi përfshiu gjithsej 46 komuna, që mbulojnë i mjediset urbane dhe rurale, të përzgjedhura në mënyrë përfaqësuese nga të tetë rajonet statistikore të vendit. Puna në terren u zhvillua nga 12 deri më 30 korrik të vitit 2021.

Marzhi i gabimit statistikor për hulumtimet e këtij lloji është +/-3 për qind, që është një devijim normal për këtë mostër reprezentative.

## 9. Demografia

Tabela		përqindja
Gjinia	Mashkull	49.5 për qind
	Femër	50.3 për qind
	Preferoj të mos përgjigjem	0.3 për qind
Grupmosha	15 – 29	22.7 për qind
	30 – 49	36.1 për qind
	50 – 64	23.6 për qind
	65+	17.6 për qind
Statusi i punësimit	i/e punësuar në sektorin privat	30.7 për qind
	i/e punësuar në sektorin publik	17.3 për qind
	Institucion ndërkombëtar	0.1 për qind

	Sektorin e OJQ-ve	0.7 për qind
	i/e papunësuar	12.4 për qind
	Nxënës/student	7.5 për qind
	Amvise	5.2 për qind
	Pronar biznesi privat	3.6 për qind
	Punonjës i pavarur	0.9 për qind
	Në pension	18.9 për qind
	Fermer	2.5 për qind
	Të tjera	0.3 për qind
Arsimi*	Nuk ka arsim/shkollim fillor i papërfunduar	2.3 për qind
	Shkolle fillore	17.0 për qind
	Arsimi i mesëm trevjeçar	5.4 për qind
	Arsimi i mesëm	45.6 për qind
	Kolegj	8.9 për qind
	Arsim sipëror, mr., dr.	20.1 për qind
	Preferoj të mos përgjigjem	0.8 për qind
Përkatësia etnike*	Maqedonas	67.0 për qind
	Shqiptar	25.2 për qind
	Serb	1.5 për qind
	Vllah	0.3 për qind
	Turk	2.5 për qind
	Rom	2.5 për qind
	Boshnjak	0.2 për qind
	Tjetër	0.7 për qind
Statusi martesor	i/e martuar/në bashkëjetesë	63.8 për qind



	Beqar/e	24.5 për qind
	Vejan/e	9.3 për qind
	i/e divorcuar	1.8 për qind
	Preferoj të mos përgjigjem	0.6 për qind
Rajoni	Vardari	7.3 për qind
	Lindor	8.6 për qind
	Jugperëndimor	10.8 për qind
	Juglindor	8.4 për qind
	Pellagoni	11.6 për qind
	Pollog	15.1 për qind
	Verilindor	8.1 për qind
	Shkupi	30.0 për qind
Vendbanimi	Qytet	60.9 për qind
	Fshat	39.1 për qind
Mesatarja e të ardhurave mujore*	Deri më 10,000 MKD	4.1 për qind
	10,000 – 18,000 MKD	13.1 për qind
	18,000 – 25,000 MKD	17.4 për qind
	25,000 – 40,000 MKD	25.6 për qind
	Mbi 40,000 MKD	28.1 për qind
	Nuk e di/Preferoj të mos përgjigjem	11.7 për qind
Të ardhurat nga bujqësia	Po	17.7 për qind
	Jo	82.3 për qind

\*Gjatë analizës së të dhënave u kombinuan disa variabla demografike, me qëllim për të nxjerrjes së përfundimeve të sakta

## 10. Shtojca – Pyetësori për publikun e gjerë

### PUBLIKU I GJERË SONDAZH I NDRYSHIMEVE KLIMATIKE DHE MJEDISIT

Adresa: \_\_\_\_\_ Telefoni: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Koha e fillimi \_\_\_\_\_ Koha e përfundimit \_\_\_\_\_ Kohëzgjatja e intervistës \_\_\_\_\_

#### **FILLIMI DHE PREZANTIMI i anketuesit**

Mirëmëngjesi, unë quhem \_\_\_\_\_ dhe punoj si anketues për Agjencinë për hulumtim Rating nga Shkupi.

Ne po e realizojmë një anketë për nevojat e UNICEF-it në Maqedoninë e Veriut, lidhur me ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit. Ne e realizojmë këtë hulumtim për të kuptuar më mirë opinionin publik dhe qëndrimet mbi ndryshimet klimatike dhe mjedisin në Maqedoninë e Veriut.

Do të ishim shumë mirënjohës, nëse do të pranoni të merrni pjesë në këtë hulumtim dhe, me përgjigjet tuaja të sinqerta, ta ndihmoni UNICEF-in t'i drejtojë më mirë programet e tij drejt nevojave të fëmijëve dhe qytetarëve, për një jetë më të mirë dhe cilësore.

Amvisëria juaj është përzgjedhur sipas përzgjedhjes së rastit si pjesë e një mostre reprezentative për vendin tonë, andaj pjesëmarrja juaj në anketë është krejtësisht anonime. Për të marrë pjesë në anketë, duhet të jeni (mbi) 15 vjeç.

Biseda do të zgjaste rreth 25 minuta. Pra a është tani koha për ta filluar bisedën?

#### **DEKLARATA E PRINDËRIVE PËR FËMIJËT 15-17 VJEÇ**

Unë, \_\_\_\_\_, në cilësinë e prindit, me vetëdije deklaroj se e lejoj fëmijën tim të merr pjesë në anketën e realizuar nga Agjencia Rating nga Shkupi, gjegjësisht nga anketuesi \_\_\_\_\_. Përpara se ta jepja lejen time, u informova se anketa do të ishte plotësisht anonime dhe se përgjigjet dhe të dhënat e marra nga fëmija im do të përpunohen në grupe dhe do të përdoren vetëm për qëllime hulumtuese.

Nënshkrimi

\_\_\_\_\_

#### **Të dhënat demografike (D1)**

##### **D1.1 Rajoni:**

1. Vardari
2. Lindor
3. Jugperëndimor
4. Juglindor
5. Pellagoni
6. Pollog
7. Verilindor
8. Shkup

**D1.2. Komuna e banimit:***(ju lusim shënojeni komunën)***D1.3. Vendi i banimit:**

1. Qyteti
2. Fshati

**D1.4. Sa vite keni që jetoni në vendbanimin tuaj aktual?** \_\_\_\_\_ *(ju lutemi shënoni me numra)*

**D1.5. Përkatësia etnike**

1. Maqedonas
2. Shqiptar
3. Serb
4. Vllah
5. Turk
6. Rom
7. Boshnjak
8. Tjetër

**1. A do të mundeni ju lutemi t'i ndani tre shqetësimet/problemet kryesore me të cilat përballemi në këtë moment?**

*(Anketuesi: Mos e lexoni këtë. Përgjigje spontane nga i anketuari. Kodoni përgjigjen në kategoritë e mëposhtme; nëse nuk mund të kodohet, shënoni në "tjetër")*

<b>Çështja</b>	<b>1.1 Çështja e parë</b>	<b>1.2 Çështja e dytë</b>	<b>1.3 Çështja e tretë</b>
Papunësia	1	1	1
Pagat e ulëta	2	2	2
Standardi i ulët/i dobët i jetesës/varfëria	3	3	3
Korrupsioni	4	4	4
Mungesa e perspektivës dhe e mundësive për të rinjtë	5	5	5
Të ardhurat e paqëndrueshme	6	6	6
Krimi dhe dhuna	7	7	7
Kushtet e këqija në Ballkan	8	8	8
Shpenzimet e larta të jetesës	9	9	9
Mungesa e demokracisë dhe lirisë së fjalës	10	10	10
Problemet dhe tensionet ndëretnike	11	11	11
Të rinjtë që emigrojnë për shkak të kushteve të këqija në vend	12	12	12
Shërbimet e dobëta shëndetësore	13	13	13
Pensionet e ulëta	14	14	14
Arsim i dobët	15	15	15
Ndotja e ajrit dhe mjedisit	16	16	16
Delikuenca e të miturve	17	17	17
Abuzim i fëmijëve	18	18	18
Ndryshimet klimatike/Ngruhja globale	19	19	19
Pandemia e Kovid-19	20	20	20
Tjetër, çfarë _____	21	21	21
Nuk ka probleme	22	22	22
Preferoni të mos e thoni <i>(Anketuesi: mos e lexoni këtë)</i>	23	23	23

--	--	--	--

**PJESA 1. NJOHURITË MBI NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE NDIKIMIN E TYRE NDAJ MJEDISIT/SHOQËRISË/NJERËZVE**

**2. Cili është mendimi juaj i parë kur e dëgjoni nocionin “ndryshimi i klimës”? (Pyetje të llojit të hapur, duhet të shkruhet përgjigja e plotë)**

99. Nuk e di/nuk është e zbatueshme (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**3. Në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 tregon se nuk jam fare i shqetësuar dhe 10 tregon se jam shumë i shqetësuar, sa jeni të shqetësuar lidhur me ndryshimin e klimës?**

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----

Nuk jam aspak i shqetësuar

Jam shumë i shqetësuar

98. Nuk ka përgjigje (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

99. Nuk e di/nuk kam dëgjuar për ndryshimet klimatike (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**4. Sipas mendimit tuaj, a do të thoni se ndryshimi i klimës ndikon në cilësinë e jetës së fëmijëve:**

1. Shumë negativisht
2. Kryesisht negativisht
3. As pozitivisht, as negativisht
4. Kryesisht pozitivisht
5. Shumë pozitivisht
9. Nuk e di (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
99. Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**5. Me cilin nga pohimet e mëposhtme jeni dakord:**

1. Ndryshimet klimatike shkaktohen kryesisht nga faktorët njerëzorë
2. Ndryshimet klimatike janë kryesisht fenomen natyror
3. Ndryshimet klimatike shkaktohen në mënyrë të barabartë nga njeriu dhe natyra
4. Asnjëra, sepse ndryshimet klimatike nuk ekzistojnë
98. Nuk e di ((për anketuesin: mos e lexoni këtë)
99. Preferoj të mos përgjigjem ((për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**6. Sipas jush, a ka ndryshuar ndonjë nga fenomenet e mëposhtme në 10 vitet e fundit? Për çdo ndryshim që jua lexoj, ju lutem më tregoni nëse ndodh më shpesh, më rrallë apo nuk ka ndryshim:**

Dukuria	Ndodh më shumë/më shpesh	Ndodh më pak/më rrallë	Nuk ak ndryshim	Nuk e di/nuk është e zbatueshme (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
6.1 Valët e të nxehtit	1	2	3	9
6.2 Valët e ftohta	1	2	3	9
6.3 Ndryshimi i stinëve	1	2	3	9
6.4 Thatësitrat	1	2	3	9
6.5 Reshjet e shiut	1	2	3	9
6.6 Përmbytjet	1	2	3	9
6.7 Zhdukja e bimëve dhe kafshëve	1	2	3	9
6.8 Dëmtimi i të korrave të shkaktuara nga insektet/sëmundjet	1	2	3	9
6.9 Zjarret në pyje	1	2	3	9
6.10 Tërmetet	1	2	3	9

**7. Sipas jush, cilat janë pasojat e ndryshimeve klimatike? (anketuesi: pyetje spontane, më shumë përgjigje janë të mundshme)**

1. Më shumë reshje
2. Më pak reshje
3. Përmbytjet
4. Thatësitrat
5. Valët e të nxehtit
6. Valët e ftohta
7. Shpyllëzimi
8. Zhdukja e bimëve dhe kafshëve
9. Mungesa e ushqimit
10. Mungesa e ujit të pijshëm
11. Më shumë sëmundje/viruse
12. Lufta për mbijetesën e njerëzimit
13. Asgjë, për shkak se ndryshimi klimatik nuk ekziston
14. Tjetër (ju lutem shënoni) \_\_\_\_\_
98. Nuk e di (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
99. Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**9. Sipas njohurive tuaja, në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 tregon “Ndikon shumë” dhe 5 tregon se “Nuk ndikon fare”, në çfarë mase secili nga aktivitetet e mëposhtme ndikon në zbutjen e ndryshimeve klimatike?**

Aktivitetet	1- ka ndikim të madh	2	3	4	5-nuk ka aspak ndikim	Nuk e di/nu k është e zbatueshme

						( për anketuesin: mos e lexoni këtë )
8.1 Ecja	1	2	3	4	5	9
8.2 Çiklizmi	1	2	3	4	5	9
8.3 Përdorimi i transportit publik	1	2	3	4	5	9
8.4 Selektimi/Riciklimi i mbeturinave	1	2	3	4	5	9
8.5 Përdorimi i llambave me efikasitet energjetik	1	2	3	4	5	9
8.6 Konsumimi i ushqimit organik	1	2	3	4	5	9
8.7 Mbledhja e mbeturinave nga hapësirat publike	1	2	3	4	5	9
8.8 Instalimi i paneleve diellore për ujë të ngrohtë në qytet dhe rrethinë	1	2	3	4	5	9
8.9 Përdorimi racional i ujit të pijshëm	1	2	3	4	5	9
8.10 Mbjellja, pyllëzimi	1	2	3	4	5	9
8.11 Reduktimi dhe ripërdorimi i mbeturinave	1	2	3	4	5	9
8.12 Kompostimi – klasifikimi i mbetjeve organike (perime, fruta, gjethe, etj.) dhe përpunimi i tyre në plehra organik	1	2	3	4	5	9
8.13 Përdorimi i pajisjeve me efikasitet të energjisë në amvisëri	1	2	3	4	5	9
8.14 Dhurimi i rrobave	1	2	3	4	5	9
8.15 Zvogëlimi i mbetjeve ushqimore	1	2	3	4	5	9
8.16 Reduktimi i konsumit të produkteve në ambalazhe plastike	1	2	3	4	5	9
8.17 Digjitalizimi i operacioneve	1	2	3	4	5	9
8.18 Instalimi i paneleve diellore në shtëpi dhe ndërtesa për prodhimin e energjisë elektrike	1	2	3	4	5	9
8.19 Më pak udhëtime ajrore	1	2	3	4	5	9
8.20 Përdorimi i drurit (për ngrohje)	1	2	3	4	5	9

**9. A mund të thoni se në dhjetë vitet e fundit cilësia e ujit është:**

1. Përmirësuar
2. Nuk është ndryshuar në masë të konsiderueshme
3. Përkeqësuar
9. Nuk e di/Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**10. A mund të thoni se në dhjetë vitet e fundit cilësia e ajrit është:**

1. Përmirësuar
2. Nuk është ndryshuar në masë të konsiderueshme
3. Përkeqësuar
9. Nuk e di/Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**11. Çfarë mendoni se kontribuon më shumë në ndryshimet klimatike? (mund të jepen më shumë përgjigje)**

1. Industria
2. Sektori i energjisë (prodhimi i rrymës)
3. Transporti dhe trafiku
4. Ndërtimtaria
5. Ngrohja e amvisërive me burime energjie jo-ekologjike
6. Ngrohja e industrisë (ngrohja e kompanive të vogla dhe më të mëdha)
7. Djegia e mbetjeve në deponitë ilegale
8. Bujqësia (p.sh. djegia e kashtës dhe kulturave bujqësore, përdorimi i kimikateve)
9. Mbarështimi i blegtorisë
98. Tjetër (ju lutem shënoni përgjigjen) \_\_\_\_\_
99. Nuk e di/Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**12. Sipas njohurive tuaja, cili nga gazrat e mëposhtëm kontribuon në ndryshimin e klimës? (më shumë përgjigje janë të mundshme)**

1. Grimcat PM 10
2. Dyoksidi i karbonit
3. Ozoni
4. Grimcat PM 2.5
5. Metani
6. Dyoksidi i squfurit
7. Dyoksidi i karbonit
8. Asnjë nga të lartpërmendurat
9. Tjetër (ju lutem shënoni përgjigjen) \_\_\_\_\_
98. Nuk e di (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
99. Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**(ANKETUESI: Vetëm nëse P11=5- Ngrohja e amvisërive me burime energjie jo-ekologjike)**

**14. Në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 tregon “Nuk ndikon aspak” dhe 10 “Ndikon shumë”, në çfarë mase ndikon në ndotjen e ajrit secili nga burimet e shënuara të energjisë, që përdoren për ngrohjen e amvisërisë?**

	Burimi i energjisë	-										+	Nuk e di / Preferoj të mos përgjigjem
14.1	Druri për djegie	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
14.2	Qymyri	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
14.3	Vaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
14.4	Peletat	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
14.5	Materialet e ndryshme mbetjesh (dru i llakuar, plastika, etj.)	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
14.6	Gazi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
14.7	Dielli	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	



## PJESA 2. QËNDRIMI NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE DHE NDIKIMI I TYRE NDAJ MJEDISIT

**15. Ju lutemi hidhni një sy listës së mëposhtme dhe zgjidhni tre çështjet që ju shqetësojnë më shumë:** (ANKETUESI: Tregoni listën. Rrethoni deri në tre nocione të listës. Nëse i anketuari nuk e di, kaloni në pyetjen tjetër)

1. Ndotja e ajrit
2. Ndotja e deteve, liqeneve dhe lumenjve
3. Përmbytjet
4. Thatësirat
5. Deponitë ilegale
6. Menaxhimi i dobët i mbetjeve
7. Bllokimi i trafikut (kultura e komunikacionit)
8. Ushqim OMGJ
9. Rritja e temperaturave të Tokës
10. Përdorimi i tepruar i burimeve të Tokës
11. Shfarosja/zhdukja e bimëve dhe kafshëve (të egra)
12. Mbetjet radioaktive
13. Mbipopullimi
14. Asnjë nga të lartpërmendurat
15. Të tjera (ju lutemi shkruani përgjigjen)

A. Këndvështrimet e qytetarëve/grupit

Në lidhje me pyetjet e mëposhtme, do të duhet të më thoni nëse dhe sa jeni dakord me to. Nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara, është e rëndësishme të shprehni mendimin tuaj.

**16. Do t'ua lexoj disa pohime. Ju lutemi tregoni nëse pajtoheni plotësisht, pajtoheni kryesisht, kryesisht nuk pajtoheni ose aspak nuk pajtoheni që:**

Pohimet	Pajtohem plotësisht	Pajtohem kryesisht	Nuk pajtohem kryesisht	Aspak nuk pajtohem	Nuk e di /Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
16.1 Njerëzit duhet të hanë mish për të mbijetuar.	1	2	3	4	9
16.2 Të mbijetosh sot është shumë më e rëndësishme sesa të shqetësohesh për atë që do të sjellë e ardhmja.	1	2	3	4	9
16.3 Vegjetarianët nuk ushqehen shëndetshëm.	1	2	3	4	9
16.4 Njerëzit që jetojnë në qytete shkaktajnë më shumë ndotje se njerëzit që jetojnë në fshat.	1	2	3	4	9
16.5 Vendet e varfra mund të bëjnë pak për t'i zbutur ndryshimet klimatike.	1	2	3	4	9
16.6 Ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale janë e njëjta gjë.	1	2	3	4	9

16.7 Ndryshimet klimatike do ta ulin cilësinë e jetës për brezat e ardhshëm.	1	2	3	4	9
16.8 Ndryshimet klimatike do ta ulin cilësinë e jetës për brezat e ardhshëm.	1	2	3	4	9
16.9 Ndryshimet klimatike nuk ndikojnë në vendin tonë.	1	2	3	4	9
16.10 Energjia e rinovueshme fitohet vetëm kur moti është me re ose me erë.	1	2	3	4	9
16.11 Ndryshimi i klimës është vullneti i Zotit.	1	2	3	4	9
16.12 Është normale që klima të ndryshojë, kështu ka qenë gjithmonë.	1	2	3	4	9

#### B. Pikëpamjet mbi zgjidhjet e mundshme për reduktim të ndryshimeve klimatike

Në vijim është dhënë një grup pohimesh në lidhje me zgjidhjet e mundshme për zbutjen e ndryshimeve klimatike.

#### 17. Ju lutemi tregoni nëse pajtoheni plotësisht, pajtoheni kryesisht, kryesisht nuk pajtoheni ose aspak nuk pajtoheni që:

Pohimet	Pajtohem plotësisht	Pajtohem kryesisht	Nuk pajtohem kryesisht	Aspak nuk pajtohem	Nuk e di /Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
17.1 Impiantet e djegies së mbetjeve paraqesin rrezik për ndotjen e mjedisit.	1	2	3	4	9
17.2 Gazifikimi është një zgjidhje për ndotjen e ajrit.	1	2	3	4	9
17.3 Energjia diellore është një zgjidhje për ndotjen e ajrit.	1	2	3	4	9
17.4 Lumenjtë duhet të përdoren për të prodhuar energji elektrike.	1	2	3	4	9
17.5 Çdo familje duhet t'i selektojë mbetjet e veta.	1	2	3	4	9
17.6 Është e kotë t'i zgjedh mbeturinat e mia kur të gjitha ato përfundojnë në të njëjtin vend.	1	2	3	4	9
17.7 Nëse blej vetëm aq sa kam nevojë do të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit.	1	2	3	4	9
17.8 Investim më i madh në edukimin mjedisor do të thotë investim në një të ardhme më të ndritur.	1	2	3	4	9

17.9 Kursimi i energjisë elektrike është i rëndësishëm sepse i zbut ndryshimet klimatike.	1	2	3	4	9
17.10 Nëse blej automjet nga BE-ja, që është favorshëm për mjedisin, do të paguaj një taksë më të ulët të importit.	1	2	3	4	9

**18. Ju lutemi tregoni a pajtoheni plotësisht, pajtoheni kryesisht, kryesisht nuk pajtoheni ose aspak nuk pajtoheni që:**

Pohimet	Pajtohem plotësisht	Pajtohem kryesisht	Nuk pajtohem kryesisht	Aspak nuk pajtohem	Nuk e di /Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
18.1 Ndryshimi klimatik është i pashmangshëm.	1	2	3	4	9
18.2 Si individ, unë mund të ndikoj në ndryshimin e klimës.	1	2	3	4	9
18.3 Unë do të ndërmarr veprime për t'i zvogëluar ndryshimet klimatike vetëm kur të gjithë të tjerët rreth meje ta bëjnë këtë.	1	2	3	4	9
18.4 Qeveria duhet t'i shpërblejë njerëzit që kontribuojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike.	1	2	3	4	9
18.5 Është shumë herët për të thënë nëse ndryshimi i klimës është vërtet një problem.	1	2	3	4	9
18.6 Informacioni për ndryshimet klimatike është i rëndësishëm për mua.	1	2	3	4	9
18.7 Punoj për ta siguruar jetesën, edhe nëse është në dëm të mjedisit.	1	2	3	4	9
18.8 Njerëzit kanë të drejtë të ndryshojnë mjedisin për t'iu përshtatur nevojave të tyre.	1	2	3	4	9
18.9 Bimët dhe kafshët i kanë të njëjtat të drejta si njerëzit.	1	2	3	4	9
18.10 Natyra është mjaft e fortë për t'u përballur me ndikimet negative të shkaktuara nga njeriu.	1	2	3	4	9
18.11 Investimi në inovacionin teknologjik kërkohet për t'i trajtuar ndryshimet klimatike.	1	2	3	4	9
18.12 Për të rritur ekonominë, dëmtimi i mjedisit është i pashmangshëm.	1	2	3	4	9
18.13 Edukata në shtëpi kontribuon në shprehitë që njerëzit i kanë në lidhje me mjedisin.	1	2	3	4	9
18.14 Shkolla është vendi më i mirë për ta zhvilluar ndërgjegjësimin mjedisor të fëmijëve.	1	2	3	4	9

### PJESA 3. PERCEPTIMI I PËRGJEGJËSISË DHE VEPRIMIT INSTITUCIONAL

19. Kur bëhet fjalë për mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, cilat do të ishin tre pohimet që sipas jush do të ishin më të përgjegjshme:

(mund të jepen deri në tre përgjigje)

	E para më e përgjegjshme	E dyta më e përgjegjshme	E treta më e përgjegjshme
1. Çdo qytetar	1	1	1
2. Qeveria	2	2	2
3. Autoritetet lokale (komunat)	3	3	3
4. Fuqitë e mëdha botërore	4	4	4
5. Organizatat ndërkombëtare	5	5	5
6. Industria e biznesit	6	6	6
7. Organizatat joqeveritare mjedisore	7	7	7
8. Ndërmarrja publike e higjienës komunale	8	8	8
9. Ndokush tjetër, kush _____	9	9	9
98. Asnjë	10	10	10
99. Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)	11	11	11

20. Çfarë mendoni se duhet të bëjë qeveria për t'i trajtuar ndryshimet klimatike dhe për të ruajtur mjedisin? (anketuesi: pyetje e llojit të hapur, duhet të shënohet përgjigja e plotë)

---

99. Nuk ka përgjigje (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

### PJESA 4. PRAKTIKAT E QYTETARËVE

21. A keni ndërmarrë personalisht ose dikush që njihni veprime të posaçme për ta mbrojtur mjedisin?

1. Po, personalisht kam ndërmarrë
2. Po, dikush që njoh e ka ndërmarrë
3. Po, unë personalisht kam ndërmarrë dhe dikush që njoh e ka ndërmarrë
4. Jo (kaloni)
5. Nuk e di (për anketuesin: mos e lexoni këtë) (kaloni)
6. Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë) (kaloni)

(ANKETUESI: Vetëm nëse P21=1,2,3)

22. Çfarë lloj veprimesh? (pyetje të llojit të hapur)

---

### 23. Sa shpesh i praktikoni aktivitetet e mëposhtme?

Aktivitete	Rregullisht (pothuajse e çdo ditë)	Shpesh (disa herë në javë)	Nganjëherë (dy deri në tre herë në muaj)	Rrallë (një herë në muan, disa herë në vit)	Aspak nuk i praktikoj
23.1 Unë eci	1	2	3	4	5
23.2 Unë ngas një biçikletë/skuter për në punë	1	2	3	4	5
23.3 Unë e përdor transportin publik	1	2	3	4	5
23.4 Unë i klasifikoj mbeturinat	1	2	3	4	5
23.5 Unë përdor llamba me efikasitet energjetik	1	2	3	4	5
23.6 Unë konsumoj ushqim organik	1	2	3	4	5
23.7 Unë i mbledh mbeturina nga hapësirat publike	1	2	3	4	5
23.8 Unë i kushtoj vëmendje konsumit të ujit	1	2	3	4	5
23.9 Unë kultivoj fruta/perime për nevojat e mia	1	2	3	4	5
23.10 Unë nuk përdor qese plastike	1	2	3	4	5
23.11 Unë e shmang përdorimin e plastikës	1	2	3	4	5
23.12 Unë dhuroj rroba	1	2	3	4	5
23.13 Unë kompostoj – klasifikimi i mbetjeve organike (perime, fruta, gjethe, etj.) dhe përpunimi i tyre në plehra organik	1	2	3	4	5
23.14 Unë gjeneroj sa më pak mbetje ushqimore	1	2	3	4	5
23.15 Unë udhëtoj me avion	1	2	3	4	5
23.16 Unë përdor dru për ngrohje	1	2	3	4	5
23.17 Unë e shmang përdorimin e plastikës	1	2	3	4	5

### 24. Cilat nga gjërat e mëposhtme keni/posedoni në shtëpinë tuaj?

Gjësëndi	Po	Jo	Nuk e di
24.1 Dritare dhe dyer me efikasitet energjetik	1	2	9
24.2 Izolimi i murit (stiropor ose tervol)	1	2	9
24.3 Izolimi i pullazit (stiropor ose tervol)	1	2	9
24.4 Kolektori diellor për ujë të nxehtë	1	2	9
24.5 Fotovoltaikë diellorë (sistem solar)	1	2	9
24.6 Pajisja e ngrohjes me efikasitet energjetik	1	2	9
24.7 Pajisja ftohëse me efikasitet energjetik	1	2	9

### 25. Sa jeni personalisht të gatshëm (motivuar) të angazhoheni në veprime për mjedisin?

1. Jam shumë i/e motivuar
2. Jam disi i/e motivuar
3. Jam disi i/e pamotivuar
4. Nuk jam aspak i/e motivuar
5. Nuk e di (për anketuesin: mos e lexoni këtë, kaloni në P28)
6. Preferoj të mos përgjigjem (kaloni në P 28)

(ANKETUESI: Vetëm nëse P25=1,2)

**26. Çfarë ju nxit/motivon të përfshiheni në veprimet mjedisore?** (në mënyrë spontane, mos i lexoni pyetjet)

1. Bindjet personale
2. Dashuria për bimët/kafshët ose kafshët e egra
3. Për të zgjidhur një problem ose nevojë specifike
4. Për të marrë njohuri të reja, për të mësuar diçka të re
5. Për socializim
6. Për të dhënë shembull për të tjerët
7. Për një jetë më të mirë për brezat e ardhshëm
8. Aktiviteti i lirë
9. Financat
10. Karriera
11. Tjetër (ju lusim shënoni përgjigjen) \_\_\_\_\_
12. Nuk e di/Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

(ANKETUESI: Vetëm nëse P25=3,4)

**27. Cila është arsyeja kryesore pse nuk jeni të gatshëm të angazhoheni në veprime mjedisore?**

1. Nuk besoj se mund të bëj fare ndryshim/Është një humbje kohe e kotë
2. Kjo nuk është puna ime, të tjerët janë përgjegjës për të
3. Nuk kam asnjë arsye të veçantë (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
4. Të tjera (ju lusim shënoni përgjigjen) \_\_\_\_\_
5. Nuk e di/Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

Një grup pyetjesh në lidhje me standardin e jetesës dhe fuqinë blerëse

**28. Sipas mendimit tuaj, cili nga pohimet e mëposhtme e përshkruan më mirë standardin aktual të jetesës në vendin tuaj?**

1. Standardi i jetesës është i padurueshëm
2. Është e vështirë për të jetuar, por është e durueshme
3. Standardi i jetesës nuk është as shumë i mirë, e as shumë i keq
4. Standardi i jetesës është i mirë, por mund të jetë më i mirë
5. Standardi i jetesës është i shkëlqyeshëm
6. Nuk e di (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
7. Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**29. Cila nga pohimet e mëposhtme vlen për ju?**

1. Mund të blej çdo gjë që dua



2. Mund të blej pak më shumë se sa më duhet
3. Mund ta blej vetëm atë që më nevojitet
4. Nuk mund ta blej as atë që më nevojitet
5. Nuk e di (*për anketuesin: mos e lexoni këtë*)
6. Preferoj të mos përgjigjem (*për anketuesin: mos e lexoni këtë*)

**30. Vitin e ardhshëm, a prisni që standardi juaj i jetesës:**

1. Do të përmirësohet
2. Do të përkeqësohet
3. Nuk do të ndryshojë ndjeshëm
4. Nuk e di (*për anketuesin: mos e lexoni këtë*)
5. Preferoj të mos përgjigjem (*për anketuesin: mos e lexoni këtë*)

**PJESA 5. MEDIAT DHE INFORMIMI**

**31. Sa shpesh i përdorni këto media/kanale për të marrë informacione?**

	<b>Rregullisht</b> (gati çdo ditë)	<b>Shpesh</b> (disa herë në javë)	<b>Ndonjëherë</b> (dy deri në tre herë në muaj)	<b>Rrallë</b> (njëherë në muaj, disa herë në vit)	<b>Aspak nuk i përdor ato</b>
31.1 Televizor	1	2	3	4	5
31.2 Radio	1	2	3	4	5
31.3 Ueb faqet/ueb portalet	1	2	3	4	5
31.4 Gazetat ditore	1	2	3	4	5
31.5 Gazetat/revistat javore	1	2	3	4	5
31.6 Mediat sociale	1	2	3	4	5

**ANKETUESI:** Nëse P33.1 merr 1-4 përgjigje nga i anketuari për televizorin, atëherë pyetni:

**32. Si burim lajmesh, cilit kanal televiziv vendas i besoni më shumë?**

1. MTV 1 – Kanali i parë (televizion nacional)
2. MTB 2 – Kanali dytë (televizion nacional)
3. MTV Sat – Kanali i parë në satelit (televizion nacional)
4. MRT – Kanali Parlamentar (televizion nacional)
5. Alfa (televizion nacional)
6. Alsat-M (televizion nacional)
7. Kanal 5 (televizion nacional)
8. Sitel (televizion nacional)
9. TELMA (televizion nacional)
10. 21 TV (KOMPANI 21- M) (televizion nacional)
11. SHENJA Skopje (televizion nacional)
12. NOVA Skopje (televizion nacional)
13. KLAN MAQEDONi Tetovo (televizion nacional)
14. TV 24 News (televizion nacional)
15. Kanal 5 Plus (televizion nacional)
16. Nasha TV (televizion nacional)

17. TV Sonce (televizion nacional)
18. Kanale televizive lokale
19. Kanal tjetër
20. Asnjërit
21. Nuk e di/Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**33. Në 6 muajt e fundit, a keni vënë re ndonjë azhurnim në media mbi temat që ndërlidhen me ndryshimet klimatike dhe mjedisin?**

1. Po
2. Jo
9. Nuk e di (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
99. Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**34. Zakonisht ku merrni informacione për ndryshimet klimatike dhe mjedisin?**

1. Televizioni
2. Radioja
3. Portalet/faqet e posaçme të internetit
4. Mediat sociale
5. Raporte projektesh, studime
6. Revista të specializuara (për shembull: revista shkencore)
7. Gazetat, mediat e shtypura
8. Ueb faqja ([www.klimatskipromeni.mk](http://www.klimatskipromeni.mk))
9. Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ( [www.moep.gov.mk](http://www.moep.gov.mk))
10. Përmes bisedës me familjen/miqtë/fqinjët
11. Nuk më interesojnë tema të këtij lloji
12. Tjetër (ju lutemi saktësoni) \_\_\_\_\_
13. Nuk e di (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
14. Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

**35. Cilat organizata ndërkombëtare i ndërlidhni me ndryshimet klimatike dhe mjedisin?**  
(për anketuesin: mos e lexoni këtë. Përgjigje spontane nga i anketuari. Kodoni këtë përgjigje në kategoritë e mëposhtme; nëse nuk mund të kodohet, shënoni në "tjetër")

1. Banka Botërore
2. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)
3. GIZ (Zhvillimi Rural, Qeverisja dhe Demokracia, Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, Zhvillimi Ekonomik dhe Punësimi)
4. UNICEF
5. USAID
6. UNDP
7. Bashkimi Evropian (BE)
8. Tjetër (shënoni cila) \_\_\_\_\_
9. Nuk e di (për anketuesin: mos e lexoni këtë)
10. Preferoj të mos përgjigjem (për anketuesin: mos e lexoni këtë)

## DEMOGRAFIA D2

### D2.1 Gjinia

1. Mashkull
2. Femër
3. Preferoj të mos përgjigjem

D2.2 Moshë: \_\_\_\_\_ vjeçar (shënoni me numra)

### D2.3 Kategoria e moshës:

1. 15 deri në 18 vjeç
2. 19 deri në 29 vjeç
3. 30 deri në 49 vjeç
4. 50 deri në 64 vjeç
5. 65 + vjeç

### D2.4 Statusi martesor

1. i/e martuar/në lidhje
2. beqar/e
3. i/e ve/jë
4. i/e divorcuar
9. Preferoj të mos përgjigjem

### D2.5 Arsimi

1. Nuk ka arsim/shkollim fillor i papërfunduar
2. Shkollë fillore
3. Arsimi i mesëm trevjeçar
4. Arsimi i mesëm
5. Kolegj
6. Arsim sipëror, mr. ose dr.
7. Preferoj të mos përgjigjem

### D2.6 Statusi i punësimit

1. i/e punësuar në sektorin privat
2. i/e punësuar në sektorin publik
3. Institucion ndërkombëtar
4. Sektori joqeveritar
5. i/e papunë
6. Nxënës/studentë (universitar)
7. Amvis/e
8. Pronar biznesi privat
9. Punonjës i pavarur
10. Në pension
11. Fermer
12. Tjetër, çfarë \_\_\_\_\_ (ju lutem shënoni)

D2.7 Sa kanë qenë mesatarja e të ardhurat mujore për amvisërinë tuaj gjatë tre muajve të fundit?

1. Deri më 10,000 denarë
2. 10,000 – 18,000 denarë
3. MKD 18,000 – 25,000 denarë
4. MKD 25,000 – 40,000 denarë
5. Mbi 40,000 denarë
9. Nuk e di / Preferoj të mos përgjigjem

**D2.8 A keni ndonjë të ardhur nga bujqësia në familjen tuaj?**

1. Po
2. Jo

**D2.9 A keni pasur ndonjë rast emigrimi të përhershëm nga vendi nga amvisëria/familja juaj në 10 vitet e fundit? Nëse po, për çfarë arsye?**

1. Po, emigracion me qëllim të vazhdimit të shkollimit të mëtejshëm
2. Po, për shkak të punës
3. Po, për një arsye tjetër
4. Nuk kemi pasur rast emigrimi
9. Preferoj të mos përgjigjem (*për anketuesin: mos e lexoni këtë*)